

## Statusi i Kosovës: Muaj të Vështirë Përpara

### I. PËRMBLEDHJE

Po rritet shqetësimi për mundësinë, që shtyrja e shkurtër për të cilën vendosi i dërguari i OKB-së, Martti Ahtisaari, në nëntor 2006, për prezantimin e propozimit të tij për statusin final të Kosovës për shkak të zgjedhjeve në Serbi, të cilat do të mbahen më 21 janar, mund të mos jet e fundit dhe se mund të zvarritet tutje deri në pjesën e dytë të vitit 2007. Liderët shqiptarë të Kosovës, mjaft të indinjuar dhe shqetësuar për shkak të kësaj shtyrje, brengosen se nuk do të mund të mbajnë nën kontroll presionin e popullit pas marsit. Duke pasur parasysh qëndrimin rus gjithnjë e më të ngurtësuar dhe qëndrimin kokëfortë, si çdoherë të Beogradit, uniteti i BE-së është jetik – larg nga të qenurit i siguruar – për zhvillimin dhe mbajtjen e procesit në rrugën e duhur, së pari në Grupin e Kontaktit i cili ka menaxhuar me Kosovën, që nga vitit 1999 dhe pastaj në Këshillin e Sigurimit ku duhet të merret vendimi final.

Një numër i shteteve anëtare të BE-së, po shfaqin shenja të ngurrimit sa i përket ndryshimit të statusit të Kosovës, përballë kundërshtimit të vazhdueshëm të Serbisë. Nëse Brukseli dështon në arritjen e shpejtë të një konsensusi brenda për brenda tij, rrezikon të trashëgoj kriza të reja të mëdha. Për Gjermaninë, veçanërisht, që do të udhëheqë me presidencën gjashtëmujore të radhës të BE-së, kjo është një sfidë e cila kërkon qasje urgjente. SHBA-të, të cilat fuqimisht përkrahin një zgjidhje të shpejtë të statusit të Kosovës, nuk do të mund ta bëjë këtë vetëm, pa angazhimin e BE-së, e cila duhet të bashkërendoj përgjegjësitë me SHBA-të, për tejkalimin e pengesave të mëdha, konkretisht për tu ballafaquar me kërcënimin e Moskës për përdorimin e vetos në Këshillin e Sigurimit.

Hezitimim e bashkësisë ndërkombëtare, shqiptarët e Kosovës e kuptojnë si rritje të pengesave për vazhdim të procesit. “Gjithçka që ne bëjmë nuk është e mjaftueshme; për çdo hap që ndërmarrim kritikohemi”, u shpreh njëri i dëshpëruar. Ahtisaari ka sinjalizuar, qartë se ai ka ndërmend të prezantoj një propozim gjithëpërfshirës dhe të qartë menjëherë pas zgjedhjeve në Serbi. Bashkësia ndërkombëtare duhet ta përkrahë ate fuqimisht, nëse dëshirohet të ecet përpara, duke pasur parasysh se koha po kalon për Kosovën. Nëse ndodh diçka e padëshirueshme, shqiptarët e Kosovës mund të

mund të fajësohen pjesërisht, të cilët nuk kanë qenë në gjendje t’i shfrytëzojnë më mirë kompetencat e kufizuara qeveritare që ju kanë dhënë atyre dhe të cilët janë të gatshëm të kërcënojnë me kaos më shpejt se sa që duhet, në vend që të bëjnë më shumë për të zvogëluar frikën e minoritetit serb. Por, është fakt i pamohueshëm se rreziku i shpërthimit rritet më shumë nëse Kosova vazhdon të jetojë pa status të zgjidhur, në vitin 2007.

Një proces i gabueshëm për zgjidhjen e statusit, i cili dështon të konsolidojë një shtet të ardhshëm brenda kufijve të tanishëm apo i cili krijon kufizime për ndihmën që BE-ja dhe organizatat tjera multilaterale mund të ofrojnë, do të jet vetëm fillim i proceseve të reja destruktive. Ndjenja e hidhërimit mund të marrë dhenë ndër shqiptarët në tërë rajonin, duke forcuar kështu ideologjinë pan shqiptare e cila do t’i gërryente kufijtë ekzistues në rajon dhe ndoshta edhe do të ofronte një teren të përshtatshëm për radikalizmin mysliman.

Disa zyrtarë shprehin frikën se bashkësia ndërkombëtare mund të mos angazhohet sa duhet apo të mos ketë vullnetin e mjaftueshëm për ta zgjidhur statusin e Kosovës, pa ndodhë ndonjë krizë në teren. “Mos marrja e vendimit, në fakt është marrja e vendimit”, tërhoqi vërejtjen një diplomat në Kombet e Bashkuara. Ndërsa një tjetër theksoi: “Nëse situata në teren është e qëndrueshme, Këshilli i Sigurimit, më parë do të zgjedh të mos bëj asgjë se sa të bëjë diçka që është shumë e vështirë”. Një zyrtar evropian i ngarkuar me çështjen e sigurisë, përshkroi hapur qëndrimin i cili nuk është qëndrim i vetëm disave në bashkësinë ndërkombëtare: “I lere të ndodhin trazira pastaj e shohim. Zgjidhja e statusit të Kosovës do të përcaktohet nga një rrëmujë e madhe apo dhunë në muajin mars”.

Duhet të dëshmohej se kjo është e gabuar. Bashkësia ndërkombëtare duhet të mbajë premtimin të cilin e kishte dhënë në mënyrë të nënkuptuar dhe eksplicite. Veçanërisht:

- Grupi i Kontaktit nuk duhet të lejojë shtyrje tjetër të propozimit të Ahtisaarit pas 21 Janarit 2007, e as të ndryshojë përmbajtjen e tij. Ai gjithashtu, duhet t’i përcjell ato propozime menjëherë në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për shqyrtim.

- Këshilli i BE-së duhet, që përgatitjet dhe kërkesat e tij për marrjen e përgjegjësi në Kosovën e pas statusit, t'i bëjë më të hapura dhe më të zëshme si për opinionin publik europian ashtu edhe për Këshillin e Sigurimit. Presidenca Gjermane e radhës duhet të shndërrojë në prioritet kyç, unitetin e shteteve anëtare, në mbështetje të propozimeve të Ahtisaarit.
- Këshilli i Sigurimit duhet të veprojë shpejt dhe pozitivisht me rastin e pranimit të propozimit të Ahtisaarit, duke e kuptuar dhe pranuar se shtyrja me gjasë do të thotë një kthim i shpejt i çështjes së Kosovës në agjendën e tyre, por në rrethana dhe gjendje krize.
- Institucionet e Kosovës duhet ta zhvillojnë dhe forcojnë qeverisjen e mirë, në mënyrë që të fitojnë më shumë legjitimitet te publiku kosovar dhe të jenë të përgatitur të ushtrojnë përgjegjësi qeverisëse në mënyrë efektive, që nga momenti i përcaktimit të statusit.
- Serbia duhet të inkurajohet që të angazhohet në projektin për pavarësinë e Kosovës dhe të nxjerr përfitimet më të mëdha të mundshme për interesat e saj afatgjate dhe për minoritetin serb në Kosovë, nga ky proces, por duke ia bërë të qartë se nuk e ka të drejtën e vetos mbi vendimin e bashkësisë ndërkombëtare për statusin e Kosovës.

## II. PROPOZIMI I AHTISAARIT: KALIMI NËN BRESHËRI

Më 10 nëntor 2006, i dërguari special i OKB-së për Kosovën, i vendosur në Vjenë, ish Presidenti finlandez, Martti Ahtisaari, u pajtua ta shtyj prezantimin e tij për statusin e ardhshëm të Kosovës deri pak pas zgjedhjeve parlamentare në Serbi, të caktuara për 21 janar 2007.<sup>1</sup> Ai ka ndërmend, që kah fundi i muajit janar apo në shkurt, të ia dorëzojë palëve propozimin e tij dhe do të kërkojë prej tyre të paraqesin komentet e tyre, dhe në fund të marr aprovimin e Grupit të Kontaktit<sup>2</sup>, ku pastaj propozimi mund të paraqitet para Këshillit të Sigurimit, për marrjen e vendimeve. Por, sa shtyrje do të shkaktojë çdo fazë dhe a do të veprojnë Grupi i Kontaktit e Këshilli i Sigurimit me shpejtësinë e duhur, në mënyrë që vendimet e tyre të mos merren pas veprimeve apo ndonjë ngjarje tjetër në teren?

<sup>1</sup> Shih raportin e Grupit të Krizave për Europë Nr.177, *Statusi i Kosovës: Shtyrja Sjell Rreziqe*, 10 nëntor 2006. Zoti Ahtisaari, po ashtu ishte udhëheqës i Grupit të Krizave.

<sup>2</sup> SHBA-të, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia.

## A. NË EUROPE

Me publikimin e tij, propozimi i Ahtisaarit me gjasë do të shkaktojë disa goditje morale pritjeve të shqiptarëve të Kosovës dhe, respektivisht, ndaj shpresës së mbajtur në Serbi, se pavarësia mund të pengoj pafundësisht. Mediat dhe zyrtarët serb kanë kritikuar të dërguarin vazhdimisht gjatë muajve të kaluar, por një diplomat perëndimor parashikoi se si Beogradi “do të kriset” kur të bëhet prezantimi i propozimit. Një diplomat tjetër i lartë tha, se pas publikimit të tij dhe rreshtimit të shumë shteteve në mbështetje të tij “do të jetë mbresëlënëse”.<sup>3</sup> E tëra kjo mund t'i mundësojë procesit më shumë durim nga ana e shqiptarëve të Kosovës, nëse është e nevojshme.

Pritet, megjithatë, se plani i Ahtisaarit, nuk do ta përmend, në mënyrë eksplicite fjalën “pavarësi” – statusi do të dal si rezultat i njohjes bilaterale pastaj. Pritet që ai, megjithatë, të ndërtojë dhe ofrojë një kornizë të fortë për pavarësi – ai ka thënë se statusi i Kosovës duhet të jetë legalisht dhe politikisht i qartë<sup>4</sup> – por propozimi i tij mund të ketë nevojë për krasitje për të kaluar dhe t'u aprovuar në Këshillin e Sigurimit pa (për të iu shmangur) veton Ruse. Si do që të jetë, sa më e gjerë të jetë mbështetja e autoriteteve ndërkombëtare ndaj propozimeve, në fillim të vitit 2007, aq më të mëdha janë gjasat për një proces të mbarë dhe të qëndrueshëm.

Ahtisaari gëzon autoritetin moral dhe politik për ta përgatitur dhe ofruar draft vendimin (propozimin) për të ardhmen e Kosovës, të cilin Grupi i Kontaktit nuk mund ta arrij vet. Një diplomat tha, Ahtisaari është aty “për ne, për tu fshehur pas tij”.<sup>5</sup> Por, Grupi i Kontaktit do të duhet të veprojë posa Ahtisaari ta bëjë të njëjtën, edhe pse kohezioni brenda tij është zbehur, siç e përshkroi një diplomat, që nga “periudha e artë”, atëherë kur në tetor 2005, ai publikoi “Parimet Udhëzuese”, të pasuar me deklaratën ministrore të Londrës, të janarit 2006. Një zyrtar i angazhuar në punën e këtij trupi, shprehu shpresën, por jo edhe i bindur, se nëse plani i Ahtisaarit mbështetet fuqishëm nga SHBA-të, do ta shtynte dhe detyronte Grupin e Kontaktit të ballafaqohet me zgjidhjen e vështirë. Me arritjen e planit në tavolinën e tij (Grupit të Kontaktit), ata së paku duhet të bëjnë publike reagimet eventuale kundërthënëse ndaj këtij plani, duke iu kërkuar shteteve anëtare të cilat ngurrojnë apo e kundërshtojnë propozimin, në mënyrë obligative që të ofrojnë alternativë nëse kanë.<sup>6</sup>

<sup>3</sup> Intervista të Grupit të Krizave, nëntor 2006.

<sup>4</sup> Në adresimin e tij në konferencën e Forumit Europian, Berlin, më 1 dhjetor 2006.

<sup>5</sup> Intervistë e Grupit të Krizave me një diplomat, 16 nëntor 2006.

<sup>6</sup> Intervistë e Grupit të Krizave me një diplomat, 17 nëntor 2006.

Ahtisaari dhe gjysma e Grupit të Kontaktit (SHBA-të, Mbretëria e Bashkuar dhe Franca) dëshirojnë respektimin e orarit, që është menjëherë pas zgjedhjeve në Serbi. Ata parashohin sjelljen e rezolutës së re në Këshillin e Sigurimit, që në fillim të muajit mars 2007. Me këtë mendohet, me gjasë, që zgjidhja t'i imponohet Serbisë, në periudhën para formimit të qeverisë së re. Kjo do të ketë disa avantazhe praktike, meqë politikanët në Beograd do të jenë të liruar nga përgjegjësia para votuesve të tyre për këtë çështje dhe do t'i mundësonte vendit të tyre me kufijtë tij më në fund të përcaktuar, orientimin drejt integritimit Euro-Atlantike.

Mirëpo, shumë shtete anëtare të BE-së, duke përfshirë edhe ato të cilat janë edhe anëtare të Grupit të Kontaktit, Italia dhe Gjermania, duket se preferojnë të presin formimin e qeverisë së re serbe dhe pastaj të provojnë t'i zgjidhin disa aspekte të paketës me të.<sup>7</sup> Disa të tjera, siç është Spanja, Greqia, Qipro dhe Rumania, anojnë ka pozicioni serb.<sup>8</sup> Me këto dallime në mesin e evropianëve, Grupi i Kontaktit do të provokohet për shtyrje dhe vonesa të mëtutjeshme. Siç kishte ndodhur pas zgjedhjeve të dhjetorit 2003, qeveria e re serbe mund të mos krijohet me muaj të tërë, ku pastaj me gjasë do të shpallen zgjedhjet e reja presidenciale. Nëse kështu, presidenti i tanishëm, Tadiq, mund të kërkojë nga qeveritë perëndimore të cilat e përkrahin atë dhe e cilësojnë si të moderuar, shtyrjen prapë të vendimeve për statusin e Kosovës: "Nëse e bëtë njëherë për [kryeministrin] Koshtunicën, pse jo për mua?"

Tejet më ndryshe nga evropianët hezitues, Rusia ka insistuar se propozimi i Ahtisaarit, nuk duhet të shihet si paketë finale për tu imponuar, por si bazë për një raund të ri të bisedimeve bilaterale në mes Prishtinës dhe Beogradit, në vitin 2007. Që nga tetori 2006, Moska, vazhdimisht, ka bërë të qartë pozicionin e vet duke e përforcuar, se nuk do të mbështesë një zgjidhje që do t'i imponohet Beogradit, as në Grupin e Kontaktit e as në Këshillin e Sigurimit. Një diplomat rus shpjegoi se, "nëse Serbia pajtohet me pavarësinë përkundër dëshirës së saj, në rregull, por ne nuk e fshehim faktin se preferojmë mbetjen formale të Kosovës në Serbi".<sup>9</sup>

Më herët, Rusia dukej se pranonte se pavarësia e Kosovës ishte opsioni i vetëm, dhe se procesi për

arritjen e saj duhet të menaxhohet e jo të ngatërrohet<sup>10</sup> Ajo kundërshton idenë se ora po ec rrezikshëm, në Kosovë dhe po ashtu kritikon anëtarët tjerë të Grupit të Kontaktit, për inkurajimin e shqiptarëve të Kosovës që të besojnë se zgjidhja e imponuar është e mundshme. I sfiduar me mendimin se mohimi i pavarësisë për një kohë më të gjatë është i rrezikshëm, një diplomat u përgjigj: "A duhet të ia lëmë dhunës?" dhe pastaj përshkroi shoqërinë shqiptare të Kosovës, si të kontrolluar, strukturuar dhe klanore, ku "asgjë nuk ndodh në mënyrë spontane".<sup>11</sup>

Rusia kishte nënshkruar deklaratat e Grupit të Kontaktit, të cilat, në fakt eliminonin opsionet tjera veç pavarësisë së kushtëzuar, "nuk duhet të mundohen të na mashtrjnë", tërhoqi vërejtjen një diplomat perëndimor.<sup>12</sup> Vetoja në Këshillin e Sigurimit është fuqia e vërtetë e saj dhe "sa më afër që çështja i afrohet New Yorkut, aq më shumë Moska bën të qartë qëndrimin e saj".<sup>13</sup> Ajo edhe mund të tërhiqet në Grupin e Kontaktit, nëse të tjerët aty, përkrahin një kalim të shpejtë të paketës së Ahtisaarit në New York, por do të mbetet e lirë të veprojë si të dojë në Këshillin e Sigurimit.

Për t'i marr parasysh pretendimet e Ruisë, e cila insiston se "ky nuk ishte proces i kompletuar i negociatave",<sup>14</sup> Ahtisaarit do t'i duhet të dëshmojë se ai i ka harxhuar të gjitha opsionet me Beogradin. Atij mund ti duhet, si për shembull, të organizojë dy-tri takime të reja me palët edhe pse Prishtina do të ndjehet e trishtuar dhe zemëruar me një vazhdim të negociatave, në të cilat, ajo beson se i ka kaluar vijat e kuqe në çështjen e decentralizimit dhe frikësohet se këto negociata mund të shkaktojnë shtyrje të reja e ndoshta edhe dobësimin edhe më shumë të paketës.

Zgjedhjet në Serbi nuk do të ndryshojnë qëndrimin e Beogradit për Kosovën, por mund të kenë ndikim të madh në atë se si bashkësia ndërkombëtare do t'i qaset më tutje çështjes së statusit. Nëse partitë ekstreme nacionaliste dalin fituese apo edhe vetëm më të fuqishme se sot, nga këto zgjedhje, Rusia do të duhet ta pranojë se mundësitë për një zgjidhje të negociuar nuk

<sup>7</sup> Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar italian, 17 nëntor 2006.

<sup>8</sup> Diplomati nga shtetet Evropiane që kanë qasje më të kujdesshme, shprehën brengosjen e tyre për mos gjetjen e mesit, të cilën Ahtisaari e kërkonte më herët: gjysëm të negociuar e gjysëm të imponuar; "askush nuk duhet t'i nënvlerësojë pasojat e një zgjidhje të imponuar"; dhe "Barra e një zgjidhje sa më pak të imponuar do të jet më e lehtë për ta bartur në të ardhmen". Intervista të Grupit të Krizave, nëntor 2006.

<sup>9</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, 17 nëntor 2006.

<sup>10</sup> Intervistë e Grupit të Krizave me një diplomat perëndimor, 13 nëntor 2006.

<sup>11</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, 17 nëntor 2006.

<sup>12</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, 16 nëntor 2006.

<sup>13</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, 17 nëntor 2006. Qëndrimi i Ruisë në takimin e Këshillit të Sigurimit, të mbajtur më 13 dhjetor për Kosovën, ilustron këtë. Ambasadori, Churkin kritikoi shefin e UNMIK-ut, Rucker, për përkrahjen e tij për një zgjidhje të shpejtë të statusit, duke i quajtur të pa baza kritikën për qasjen dhe qëndrimin e Beogradit. Ai insistoi se vetëm një zgjidhje e negociuar do të mund të kalojë në Këshillin e Sigurimit. Procesverbali mund të gjendet në:

<http://www.un.org/Depts/dhl/resguide/scact2006.htm>.

<sup>14</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, 17 nëntor 2006.

ekzistojnë dhe me këtë rast konteksti ndërkombëtar, për një zgjidhje të imponuar do të jetë më i fuqishëm. Nëse partia Demokratike dhe partitë tjera, të cilat konsiderohen demokratike nga bashkësia ndërkombëtare, fitojnë në zgjedhje, të gjithë anëtarët e Grupit të Kontaktit, mund lehtë të pajtohen për një angazhim të ri për minimizimin e dallimeve mes Prishtinës dhe Beogradit, duke pranuar kështu, një shtyrje të mundshme deri ka mesi i vitit. Për të siguruar një pranim të ndonjë forme apo ndonjë pjese të planit të Ahtisaarit, nga ana e Beogradit, ata mund ta stimulojnë me fillimin e negociatave për anëtarësim në BE, veç asaj për Partneritet për Paqe (PfP), të cilën Serbia tani më e ka pranuar.<sup>15</sup>

Por me gjasë do të ndodh diçka në mes këtyre dy opsioneve ekstremeve, ku në këtë rast, Grupi i Kontaktit dhe shtetet anëtare të BE-së duhet të jenë të kujdesshme të mos i mbivlerësojnë forcat demokratike dhe elementet pro Europiane në politikën serbe.<sup>16</sup> Vetëm koalicioni i vogël i katër partive LDP-GSS-SDU-LSV, të pa përfaqësuar në parlament deri më sot, i udhëhequr nga Çedomir Jovanović, ka qasje europiane dhe bën politikë realiste ndaj Kosovës; siç duket Partia Demokratike e Tadiqit iu është bashkuar nacionalistëve tjerë, në qasjen e ashpër ndaj Kosovës,<sup>17</sup> në përpilimin e kushtetutës së re me shumë të meta në fillim të vitit dhe në referendumin, rezultati i të cilit ishte i dyshimtë, përmes të cilit u aprovua kjo kushtetutë. Me gjasë, forma e qeverisë së re do t'i ngjajë kësaj të sotmes, por Tadiqi dhe Koshtunica, sidoqoftë, do të kërkojnë shtyrje të re për Kosovën, duke insistuar se më në fund, ata janë të përgatitur të zhvillojnë negociata serioze. Pas asaj, që

<sup>15</sup> Më 29 nëntor, NATO mori vendim për pranimin, pa kushte, të Serbisë në Programin Partneritet për Paqe, duke u tërhequr nga kushtet e më hershme që kishin të bënin me bashkëpunimin e saj me Tribunalin e Hagës, posaqërisht me arrestimin dhe ekstradimin e Gjeneralit Rako Mladiq. Kryeprokurojta e Hagës, Kalra Del Ponte, e cilësoi këtë vendim si shpërblim për mosbashkëpunimin e Serbisë. Shih "Kumtesën e Tribunalit", Institutit për Raportim në Luftë dhe Paqë (IWPR), 1 dhjetor 2006, [www.iwpr.net](http://www.iwpr.net). Një përpjekje për rifillimin e negociatave për Asocim dhe Stabilizim dështoi, në samitin e BE-së, më 14-15 dhjetor; Komisioneri për Zgjerim, Rehn, kundërshtoi këtë koncesion edhe pse Përfaqësuesi i lartë i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri dhe një numër shtetesh dihet së e shohin ndryshe këtë qëshetje. Shih Reuters, "BE-ja shqyrton mundësinë e negociatave me Serbinë pas zgjedhjeve – Solana", 4 dhjetor 2006.

<sup>16</sup> Shih Brifingun e Grupit të Krizave për Europë Nr.44, Kushtetuta e Re e Serbisë: Zbrasja e Demokracisë, 8 nëntor 2006 dhe Raportin e Grupit të Krizave nr.154, Kthimi U i Serbisë, 26 mars 2004.

<sup>17</sup> Tadiqi i cili, megjithatë, ka qasje më realiste se Koshtunica deklaroi: "Mundësia që Kosova të bëhet e pavarur është e madhe", "Pesimizmi dhe optimizmi për Kosovën", B92, 11 dhjetor 2006.

ata mendojnë se kanë dhënë maksimumin dhe pas kalimit të pjesës më të madhe të vitit në negociata të pafrytshme me përfaqësues serb të nivelit të ultë, shqiptarët e Kosovës, megjithatë, vështirë se do ta pranojnë këtë taktikë, edhe nëse kjo do ti kushtonte atyre me etiketim nga bashkësia ndërkombëtare si palë jo bashkëpunuese.<sup>18</sup>

Duke dëshmuar qëndrimin aspak të zbutur ndaj Kosovës, qeveria e Serbisë i shfrytëzoi koncesionet e ofruara, siç ishte ftesa e NATO-s për Partneritet për Paqe, për ta deklaruar si fitore, duke ashpërsuar tonin edhe më shumë. Zëdhënësi i qeverisë, me rasi të vendimit për PFP, tha, "është mirë që është hequr dorë nga politika e vënies së kushteve, e cila deri më tani, kishte prodhuar rezultate negative,<sup>19</sup> ndërsa, Koshtunica e komentoi kështu: "Si anëtar i Partneritetit për Paqë, Serbia është më e sigurt në ruajtjen e integritetit dhe se Kosova do të mbetet në Serbi, me një autonomi substanciale dhe të përshtatshme".<sup>20</sup> Një vëzhgues me përvojë të madhe në Ballkan, theksoi se mungesa koordinimit të kushteve kishte qenë një "googol" për politikën në Ballkanin Perëndimor, gjatë pesëmbdhjetë viteve të kaluara: "Kjo e kishte trimëruar Millosheviqin dhe të tjerët të veprojnë sa më gjatë që mundën."<sup>21</sup>

Edhe pse dalja e vogël në votime për miratimin e referendumit tregon se është bërë më e vështirë, për politikën në Beograd, të mobilizojë publikun serb për çështjen e Kosovës. Dinamika e zhvillimeve politike serbe nuk do të u lejoj liderëve të tyre, të arrijnë një vendim të arsyeshëm në lidhje me Kosovën, aq më pak brenda kohës së nevojshme. Bashkësia ndërkombëtare duhet ta pranojë këtë fakt dhe të mos pres pafund për një marrëveshje që nuk do të ndodh. Edhe pse politikanët e saj nuk janë të gatshëm dhe janë të paafët ta pranojnë, një Kosovë stabile është interesi real i Serbisë. Një zyrtar i lartë serb, raportohet ta ketë pranuar se bllokimi i pavarësisë do t'i kushtojë Serbisë: "Një valë e re e dhunës mund të shfaqet në territorin e Kosovës, e cila do

<sup>18</sup> Liderët shqiptar të Kosovës, siç është Presidenti Sejdiu dhe Veton Surroi kanë përjashtuar mundësinë e pjesëmarrjes në negociata, në vitin 2007, me Serbinë për çështjen e Statusit. Politikanët shqiptar të Kosovës konsiderojnë se pretendimi i përsëritur kushtetues i Serbisë mbi Kosovën ka përmbyllur negociatat dhe bën të pamundur zhvillimin e negociatave të reja. Një politikan i PDK-së theksoi se Parlamenti i Kosovës do të refuzojë t'i jap mandat liderëve (Ekipit të Unitetit) për vazhdimin e negociatave. Intervistë e Grupit të Krizave, në fillim të dhjetorit 2006.

<sup>19</sup> Deklaratë e Serdjan Djuriq për televizionin shtetëror serb, RTS, cituar nga Agjencioni raportues ditor, VIP, 29 nëntor 2006.

<sup>20</sup> "Perspektiva e Kosovës" 31, KUMT Consulting, 1 dhjetor 2006.

<sup>21</sup> Zyrtar ndërkombëtar i angazhuar në Ballkanin Perëndimor, diskutime në Grupin e Krizave dhe të tjerë, nëntor 2006.

të nxishte një eksod të ri serb nga atje dhe kështu do ta dëmtonte besimin dhe pozicionin e Serbisë dhe investimet ndërkombëtare në vend”.<sup>22</sup>

## B. NË NEW YORK

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999), e cila e mban Kosovën nën autoritetin transitor të OKB-së, mbetet në fuqi derisa të merret një vendim i ri për zëvendësimin e saj. Atje, në Këshill, nuk ka patur konsultime preliminare të mjaftueshme për përgatitjet e nevojshme për propozimin e Ahtisaarit. Si organ, Këshilli i Sigurimit do të silltet kujdesshëm kur vjen në pyetje marrja e një territori të një shteti kundër vullnetit të tij. Një zyrtar i OKB-së beson se shtetet perëndimore anëtare të Këshillit, i kanë lënë anash rusët deri më tani, duke mos biseduar me ta për shkak të frikës së ata mund t’i kërkojnë atyre një çmim për këtë: “Diskutimet mund të fillojnë vetëm kah fundi i janarit”.<sup>23</sup> “Nuk kemi biseduar hapur”, u pajtua një zyrtar kinez, i cili shtoi se do të ishte e pazakontë të përkrahet një pavarësi që kontestohet, duke shtuar se një zgjidhje e negociuar do të ishte më e mirë për rajonin.<sup>24</sup>

Çështja e Kosovës, do të arrijë në New York, në kohën kur me gjasë diplomacia amerikane do të jetë dobësuar, për shkak të largimit të ambasadorit të saj të fuqishëm dhe kur lëvizjet në Këshillin e Sigurimit do të bëhen shumë të vështira,<sup>25</sup> për shkak të përplasjeve SHBA-Rusi në një numër çështjesh. “Njerëzit këtu, e cilësojnë çështjen e Kosovës si analoge me atë të Iranit; skenarët janë të njejtë, ku Rusia dhe Kina qëndrojnë kundër të tjerëve”, theksoi një diplomat.<sup>26</sup> Marrëdhëniet e Moskës me BE-në janë të tendosura: në samitin BE-Rusi, më 24 nëntor, Polonia vendosi veton e saj ndaj bisedimeve për një Marrëveshje për Bashkëpunim dhe Partneritet; menjëherë pas helmimit misterioz të Litvinenkos në Londër, Presidenti i Komisionit European, Barroso, deklaroi: “Ne kemi një problem me Rusinë”.<sup>27</sup> Tashmë,

Rusia po e përdor energjinë dhe përfitimet prej saj për ripërtrirjen dhe rritjen e ndikimit të saj, të cilin e kishte humbur gjatë viteve 90-ta. Duke iu referuar Kosovës, një njohës i Kombeve të Bashkuara, disi u pajtua me qëndrimin e liderëve të tanishëm rus, të cilët “besojnë se ngjarjet e periudhës Chernomyrdin-Ahtisaari, të vitin 1999, ishin dështim për politikën e jashtme ruse”.<sup>28</sup> Kosova, tani, ofron një mundësi për Moskën, por çka dëshiron ajo të nxjerr nga kjo mundësi?

I pyetur për këtë, një diplomat i lartë amerikan insistoi: “Ata nuk e dinë. Nuk kanë arsye pse të vendosin tani, ...Rusët do të presin nga ju që t’i merrni vendimet e pastaj të ju shosisin nervat”.<sup>29</sup> Nuk duket se Rusia paramendon të përfitojë me pavarësinë e Kosovës për diçka të njejtë në Abkhazi, Osetinë Lindore dhe Transdnistri.<sup>30</sup> “Ne nuk po kërkojmë shkëmbimin e këtyre territoreve për shkak të Kosovës: këto janë thjesht spekulime. Në të gjitha këto raste ne po kërkojmë një marrëveshje të negociuar në mes të palëve të përfshira,” tha një diplomat.<sup>31</sup>

Një vëzhgues në OKB, vuri re se paralelet që Rusia ka tërhequr në mes këtyre tri territoreve dhe Kosovës, përputhen vetëm sipërfaqësisht: “Ata nuk e besojnë këtë as vet....ata duan një status quo në Kaukaz”.<sup>32</sup> Konfliktet e pazgjidhura atje, janë një vegël për të, si për shembull, për të vazhduar presionin mbi liderin gjorgjian, Saakashvili. Në të vërtetë, kjo mund të jetë një arsye e fortë për Rusinë, për të shtyre zgjidhjen e statusit së Kosovës, sa më gjatë të jetë e mundur.

Një diplomat perëndimor sugjeroi se negociimet me SHBA-në, për çështjen e Iranit dhe Gjeorgjisë mund të jetë përcaktuese, më në fund, për qëndrimin rus në lidhje me Kosovën, në vitin 2007,<sup>33</sup> edhe pse një diplomat i

---

paralajmëruar atë është i helmuar gjithashtu”, *The Guardian*, 2 dhjetor 2006, [www.guardian.co.uk](http://www.guardian.co.uk).

<sup>22</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, New York, 16 nëntor 2006. Shih librin e John Norris, *Collision Course: NATO, Russia, and Kosovo* (Westport dhe Londër, 2005), për më shumë informata për angazhimin diplomatik të ish Kryeministrit rus, Victor Chernomyrdin dhe Z. Ahtisaari (në atë kohë, President i Finlandës dhe Udhëheqës i radhës i Presidencës së BE-së) gjatë periudhës së vitit 1999 për Kosovën. Rezultati i atij angazhimi, në Moskë, shihet si dëmtim dhe zmbarsje e pozitës ruse.

<sup>23</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, nëntor 2006.

<sup>30</sup> Abkhazia dhe Osetia Lindore nuk e shohin veten si kod për Rusinë, por udhëheqësia e Gjeorgjisë, po. Shih Raportet e Grupit të Krizave Nr.176, *Abkhazia Sot*, 15 shtator 2006; Nr.159, *Gjeorgji: Evitimi i Luftës në Osetinë Lindore*, 26 nëntor 2004; dhe Nr.175, e Ardhmja e Paqartë e Moldavisë, 17 Gusht 2006.

<sup>31</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, 17 nëntor 2006.

<sup>32</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, New York, 16 nëntor 2006.

<sup>33</sup> Intervistë e grupit të Krizave, nëntor 2006.

---

<sup>22</sup> Tim Judah, “Priten shtyrje të reja të pavarësisë së Kosovës”, *Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)*, 23 nëntor 2006. Shih [www.birn.eu.com](http://www.birn.eu.com)

<sup>23</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, New York, 16 nëntor 2006.

<sup>24</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, 16 nëntor 2006.

<sup>25</sup> Ambasadori kontraverz i SHBA-ve, John Bolton, ka dhënë dorëheqje. Pritet që, misioni amerikan në OKB, të udhëhiqet për disa muajt nga i dërguari me punë, Alejandro Wolff, një diplomat profesionist dhe i respektuar, por megjithatë, i mungon mbështetja politike e cila vjen nga lidhjet e ngushta me Shtëpinë e Bardhë.

<sup>26</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, New York, 17 nëntor 2006.

<sup>27</sup> “Në fakt, në kemi disa probleme. Shumë njerëz janë vrarë dhe ne nuk e dimë se kush i ka vrarë”, vazhdoi ai. Cituar nga fjalimi i tij, më 1 dhjetor në Ian Cobain, Ian Sample and Mark Rice-Oxley, “Çështja Litvinenko: tani edhe njeriu që e kishte

lartë amerikan insiston se: “Ne nuk bëjmë pazar. Ata e dinë se [a quid pro quo] nuk është në mesin e letrave”.<sup>34</sup> Një diplomat europian tërhoqi vërejtjen se, megjithatë, po të mos ishte bërë i qartë fati i Kosovës që nga fillimi, ajo nuk do të kishte pasur ndikim në konfliktet e ngrira në vendet e ish-Bashkimit Sovjetik, “tani po ia mundëson Rusisë, që të dërgoj sinjale të qarta të dominimit, vendeve ish-Sovjetike dhe për konsekuencat që ato do të mund të ballafaqohen në rast të afrimit më të madh me Perëndimin”.<sup>35</sup> Nën Sekretari i shtetit, Nicholas Burns, sfidoi publikisht deklaratën e zyrtarëve rus, se do ta përdorin veton ndaj një marrëveshje që nuk do të pranohej nga Serbia.<sup>36</sup> Por, a janë amerikanët dhe anëtarët tjerë të NATO-s, të cilët kontribuojnë me trupat e tyre dhe fonde për sigurinë e Kosovës përmes KFOR-it, të gatshëm ta thonë qartë se një zgjidhje e duhur dhe e drejtë e statusit të Kosovës është interes vital nacional, dhe ta bindin Rusinë se obstrukcionet do të kushtojnë shumë?

Deri para disa muajve, Kina dukej se pajtohej me pavarësinë e paevitueshme të Kosovës dhe u kufizua në bregat e saj për minimizimin e efektit domino të kësaj pavarësie. Me sa dukej, Pekini ishte i gatshëm ta përkrah qëndrimin që kishin dhe ndanin, Ahtisaari dhe qeveritë perëndimore, se Kosova duhet të shihet si rast unik dhe se zgjidhja e statusit të saj nuk mund të aplikohet për entitetet tjera, që pretendojnë të pavarësohen. Promovimi, që Rusia po i bën rastit të Kosovës, si precedent potencial për tu përdorur në “fqinjësi”, megjithatë, ka tërhequr vëmendjen e Kinës e cila siç po duket është gati të mbajë anën e Moskës. “Ne ... duhet të mendojmë në perspektive globale; cilat do të jenë pasojat? ... Këshilli i Sigurimit duhet të jetë përgjegjës për tërë botën, jo vetëm për Serbinë dhe Kosovën”.<sup>37</sup>

Është ende herët të dihet pozicioni i 10 (dhjetë) anëtarëve jo permanente në Këshillin të Sigurimit.<sup>38</sup> Nëse pesë anëtarët e përhershme pajtohen, me gjasë edhe të tjerët do ta mbështesin atë qëndrim. Por, nëse të parët mbeten të ndarë dhe veçanërisht, nëse kjo ndarje zgjerohet edhe në mesin e shteteve anëtare të BE-së, shqetësimi rreth

çështjes së integritetit territorial dhe mos ndryshimit të kufijve, mund t’i shtyj disa nga anëtarët jo të përhershme të pozicionohen ndryshe. Do të ishte joserioze, të bëhen këso vlerësime të nxituara se, për shembull, tri qeveritë afrikane do të tentojnë ta shohin rastin e Kosovës përmes thjerrëzave të tyre dhe përvojës së tyre anti-koloniale, dhe se Indonezia dhe Katari do ta shohin si rast të mirë për shprehjen e solidarizimit islamik apo se të tjerët do ta simpatizojnë Serbinë për shkak të lojalitetit ndaj Lëvizjes së të Painkuduarurve.<sup>39</sup> Realisht, disa prej tyre vetëm tani po merren dhe po e studiojnë rastin dhe vet Kosovën dhe mu për këtë, konkluzionet e Ahtisaarit do të jenë një udhërrëfyes i rëndësishëm për ta.

Një zyrtar amerikan u shpreh “shpresoj se BE-ja do të rreshtohet e para, për ta bërë solide këtë pjesë (anëtarët jo të përhershëm), dhe kështu duke na e mundësuar neve të merremi me Rusinë dhe Kinën”.<sup>40</sup> Një zyrtar tjetër më i lartë, ishte i sigurt se “nëse BE-ja dhe SHBA-të janë të bashkuar dhe kanë një qëndrim, do të jetë shumë e vështirë për Rusinë të shkaktoj vështirësi”.<sup>41</sup> Por, një diplomat europian mendon se është e rëndësishme që “ne të mos i turremi të gjithë Moskës, duke e mbështetur për muri”,<sup>42</sup> derisa një tjetër e shihte bashkëpunimin Këshilli i Sigurimit-BE, më ndryshe: “Rezoluta e Këshillit të Sigurimit do t’i përvetësoj dhe zgjidh problemet brenda BE-së”.<sup>43</sup> Tani për tani, megjithatë, BE-ja nuk shihet aspak si faktor koheziv në New York, për çështjen e Kosovës.<sup>44</sup> Përpjekjet e saj për të përgatitur dhe vendosur prezencën ndërkombëtare në Kosovë, pas UNMIK-ut, janë shumë pak të dukshme në Këshillin e Sigurimit dhe realisht edhe për vet publikun europian. Si pasojë, anëtarët e Këshillit, duke përfshirë Kinën, po informohen dhe influencohen, në mënyrë disproporcionale nga të dhënat për çështjen në fjalë, që ata marrin nga fqinjët e afërm nervoz të Kosovës në Ballkan.<sup>45</sup>

<sup>34</sup> Intervista dhe diskutime të Grupit të Krizave, 14-16 nëntor 2006.

<sup>35</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, 16 nëntor 2006.

<sup>36</sup> “Nuk mund të besoj se një anëtar i përhershëm i Këshillit të Sigurimit po kërcënohet me vendosjen e vetos, kur akoma nuk e kemi parë paketën e Ahtisaarit”, i cituar në “Burns i habitur me deklaratën ruse për vendosjen e vetos”, B92, 5 dhjetor 2006.

<sup>37</sup> Intervistë e Grupit të Krizave me një diplomat kinez, New York, 16 nëntor 2006.

<sup>38</sup> Në vitin 2007, ato janë, Republika Demokratike e Kongos, Gana, Peru, Katari dhe Sllovakia (në vitin e dytë dhe final të mandatit të saj i cili është dy vjeçar), ndërsa Panama, Belgjika, Italia, Indonezia dhe Afrika e Jugut të cilat kanë filluar vitin e parë të mandatit të tyre dy vjeçar.

<sup>39</sup> Një diplomat Indonezian nuk u pajtua me aspektin e solidaritetit islamik me Kosovën, ndërsa u shpreh më i interesuar për ndërlidhjen e çështjes me rastin e Acehut dhe me çështjet tjera të brendshme. Intervistë e Grupit të Krizave, 17 nëntor 2006.

<sup>40</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, New York, 17 nëntor 2006.

<sup>41</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, nëntor 2006.

<sup>42</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, New York, 17 nëntor 2006.

<sup>43</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, New York, 16 nëntor 2006.

<sup>44</sup> Intervista të Grupit të Krizave, New York, 16-17 nëntor 2006.

<sup>45</sup> Intervistë e Grupit të Krizave me një diplomat kinez, New York, 16 nëntor 2006. Në takimin e Këshillit të Sigurimit për Kosovën, të mbajtur më 13 dhjetor, zëvendës përfaqësuesi i përhershëm kinez, Liu Zhenmin, nuk përmendi BE-në, por theksoi: “për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, ne duhet të dëgjojmë këndvështrimet dhe mendimet e të gjitha palëve, veçanërisht të vendeve fqinjë të Kosovës”. Procesverbali mund të gjendet në

BE-ja duhet t'i shtyjë më lart planet e saj për periudhën e pas statusit në Kosovë, si për shembull, duke i publikuar projektet e planifikuara të Sekretariatit të Këshillit dhe Komisionit Europian, menjëherë pas aprovimit të tyre nga Këshilli i BE-së dhe duke dërguar një zyrat të vetin për t'i prezantuar ato dokumente në Kombet e Bashkuara.<sup>46</sup> Një koordinim i vullnetit të mirë i liderëve europian apo ministrave të jashtëm, mund të bëjë shumë për t'i dhënë mbështetje më të madhe politike mesazheve që vinë nga komisioneri për zgjerim, Rehn, në veçanti në favor të një zgjidhje legalisht dhe politikisht të qartë dhe në kohë për statusin e Kosovës. BE-ja duhet të jetë më e qartë dhe më e ashpër sa i përket "vijës së kuqe" për kalimin e përgjegjësive nga OKB-ja te ta, në Kosovë dhe duke bërë të qartë se çka i duhet atyre që Këshilli i Sigurimit të bëjë. SHBA-të duhet ta inkurajojnë një qëndrim të tillë demonstrativ, e jo të presin dhe vetëm të gjykojnë apo kritikojnë qasjen ngurruese të disa shteteve anëtare të BE-së.

Me gjasë, Këshilli i Sigurimit nuk do të mund të shpall pavarësinë e Kosovës, por ajo me siguri se mund të vendosë një bazë të fortë për të ndodhur ajo, duke vendosur autoritetin e tij në mbështetje të zgjidhjes përfundimtare edhe duke hapur rrugën dhe bërë të ditur se njohja e menjëhershme bilaterale e shtetit të ri është e mirëseardhur.<sup>47</sup> Qasja pozitive ndaj çështjes kur Ahtisaari ta sjell te ta, do të krijojë rrethana më të volitshme për unitetin brenda BE-së dhe dërgimin e misionit të saj dhe zyrës së planifikuar të Përfaqësuesit të Komunitetit Ndërkombëtar (PKN). Gjithashtu, do t'i jap mbështetje shteteve në region, në Ballkan, në periudhën kur ata do ta kenë të vështirë se si të sillen me Kosovën, para syve të Serbisë së hidhëruar.<sup>48</sup>

Një zgjidhje e tillë optimale kërkon një qëndrim relativisht pozitiv të Rusisë, por, siç është parë deri më tani, do të jetë shumë e vështirë për të pasur një qasje të tillë. Ajo që më së shumti, anëtarët perëndimor të Këshillit të Sigurimit shpresojnë të nxjerrin nga Moska është abstenimi në votim, por edhe kjo mund të ndodh me kusht që rezoluta të përpunohet deri në atë masë sa që Rusia të ndjej se e ka të drejtën legjitime për të mos e njohur zgjidhjen e dalë dhe në këtë mënyrë, do t'i ndihmojë Serbisë në fushatën e saj kundër pavarësisë. Ky skenar, më

së paku, do ta ngadalësojë procesin e njohjes nga ana e shteteve tjera duke përfshirë, ndoshta, edhe nga disa shteteve skeptike të BE-së, dhe mund të pengoj angazhimin e plotë të institucioneve financiare ndërkombëtare në Kosovë.

Edhe një rezolutë e reduktuar, e cila nuk bën më shumë se përfundimin e mandatit të rezolutës 1244 dhe me këtë të administratës së përkohshme të OKB-së në Kosovë, mund të mjaftojë për shtetet perëndimore anëtare të Këshillit të Sigurimit. "Duhet aq sa t'i mundësojë BE-së dhe SHBA-së njohjen e saj", tha një diplomat francez.<sup>49</sup> Por, nëse kështu, autoriteti i Përfaqësuesit të Bashkësisë Ndërkombëtare, të projektuar nga BE-ja do të jetë i dobët që nga vendosja e tij/saj dhe ky dislokim do të shihet me dyshim nëse rezoluta dështon ta aprovojë paketën e Ahtisaarit apo të mandatojë vendosjen e kësaj zyre dhe vazhdimin e prezencës ushtarake të NATO-s. Kur në samitin e BE-së, të mbajtur më 14-15 dhjetor 2006, kryeministri i Finlandës (udhëheqësi i presidencës së radhës), Vanhanen, u pyet për këtë, ai u përgjigj se nuk parasheh vendosjen e misionit të BE-së, pa u mandatuar nga Këshilli i Sigurimit.<sup>50</sup> Privatisht, zyrarët e BE-së thonë se: "ne nuk duhet të pranojmë dhe marrin asnjë përgjegjësi derisa nuk ka bazë të mirëfilltë dhe të qartë për angazhimin tonë".<sup>51</sup>

Ahtisaari, SHBA-të dhe mbështetësit tjerë të një zgjidhje të shpejtë, po mundohen të krijojnë ndjenjën e sigurt se marsi 2007, është muaji i vendimeve. Disa po kalkulojnë në rotacionin e presidencës së radhës në Këshill të Sigurimit<sup>52</sup> dhe në Grupin Koordinues dhe Draftues, të Grupit të Kontaktit dhe shteteve anëtarëve të BE-së në Këshillin e Sigurimit, i formuar për diskutime paraprake në çështjet e Ballkanin, në New York. Puna e tyre bazohet në pritjet se Grupi i Kontaktit do ta aprovojë paketën e Ahtisaarit në muajin mars. Një diplomat europian vuri re, kujdesshëm se, megjithatë, "Rusia nuk do të pranojë që të fillohet në New York para se qeveria e re serbe të jetë formuar.....Nëse Rusia nuk është e gatshme për të abstenuar, çfarë është qëllimi? Nuk ia vlen të turremi drejt New Yorkut, sa për të marrë veton ruse. Rezultati do të ishte sikur të mos ishte bërë asgjë".<sup>53</sup>

Një diplomat amerikan sugjeroi se maji 2007- kur SHBA-të do të kenë presidencën e radhës së Këshillit –

<http://www.un.org/Depts/dhl/resguide/scact2006.htm>.

<sup>46</sup> Një dokument i tillë do të përfshinte raportin e parë të misionit planifikues të Misionit Civil Ndërkombëtar dhe Përfaqësuesit Special të Bashkimit Europian, në Komitetin për Politika dhe Siguri, më 29 nëntor, i cili nuk është publikuar zyrtarisht, edhe pse Grupi i Krizave posedon një kopje të tij, por edhe një përmbledhje e detajuar ishte publikuar në Kohën Ditore, më 7 dhjetor 2006.

<sup>47</sup> Shih Raportin e Grupit të Krizave, Statusi i Kosovës, op. cit., f.1.

<sup>48</sup> Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrat sllovak, nëntor 2006.

<sup>49</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, nëntor 2006.

<sup>50</sup> Augustin Palokaj, "BE-ja përgatitë përgjigje të unifikuar rreth statusit të Kosovës", *Koha Ditore*, 16 dhjetor 2006.

<sup>51</sup> Intervistë e grupit të Krizave, nëntor 2006.

<sup>52</sup> Rusia udhëheqë me presidencën e Këshillit të Sigurimit, në Janar 2007, Sllovakia në shkurt, Afrika e Jugut në mars, Mbretëria e Bashkuar në prill dhe SHBA-të në maj.

<sup>53</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, New York, 16 nëntor 2006.

si realist për kalimin e rezolutës, ndërsa një zyrtar tjetër i lartë amerikan parashikon muajin qershor si afat të fundit.<sup>54</sup> Një zyrtarë italian tha: “edhe vet rusët e kuptojnë se çështja nuk do të zgjatet deri në vjeshtë”<sup>55</sup> por bëri të ditur për rrezikun e një procesi të gjatë pa rrugëdalje në Këshill.<sup>56</sup> Nëse mendohet që qëllimi të arrihet para korrikut kur ende pranimiti në heshtje i Rusisë duket i pa arritshëm dhe kur situata në teren, në Kosovë, mund të trazohet, SHBA-të, Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe shtetet tjera të vullnetshme europiane mund ta shohin më pak të dëmshëm ndërmarrjen e një qëndrimi demonstrativ dhe më të ashpër në Këshillin e Sigurimit duke e shtyrë Rusinë të vendosë veton e saj apo të qëndroj anash.

Edhe një rezolutë për të cilën është vendosur veto, për shqiptarët e Kosovës do të demonstronte, se kanë shumë përkrahës për pavarësinë e tyre, e cila do të ju kishte ndihmuar atyre dhe liderëve të tyre të përmbahen derisa përpjekjet vazhdojnë për kapërcimin e pengesave të mbetura. Në këtë rast, Rusia do të gjendej nën presion për të zbutur qëndrimin e saj. Ka mundësi, që shtetet perëndimore mund t'i japin Prishtinës, dritën e gjelbër për prurjen e pavarësisë sa më afër duke ndërmarrë disa hapa të njëanshëm, ndoshta edhe duke shpallur pavarësinë mbi bazë të paketës së Ahtisaarit. Alternativë tjetër, siç tha një diplomat perëndimor është: “Nëse ata [rusët] na e hedhin, një përgjigje është, lere të ndodhin kriza të cilat do ta sjellin çështjen prapa në Këshill të Sigurimit”.<sup>57</sup>

Edhe pse po zhvillohen disa diskutime për këtë, edhe vet mbështetësit e fuqishëm të pavarësisë shohin mundësinë për një “Plan B”, që do ta anashkalonte jo me dëshirë, Këshillin e Sigurimit, i cili mund të bëhet pengues. Disa sugjerojnë një deklaratë të presidencës së Këshillit të Sigurimit e cila do t'i mirëpriste propozimet e Ahtisaarit dhe do të shprehte një shkallë të aprovimit të saj, mund të ndihmonte në arritjen e një legjitimiteti minimal të Këshillit të Sigurimit për hapat tjerë që pasojnë.<sup>58</sup> Mirëpo, një deklaratë e tillë presidenciale kërkon aprovimin unanim të Këshillit, ku rezoluta 1244 do të mbetej në fuqi, duke shkaktuar, kështu, një mospërputhje të pavarësisë me autoritetin e OKB-së, i cili administron Kosovën. Në këso rrethanash, BE-ja dhe institucionet financiare ndërkombëtare do ta kishin të vështirë ta përkrahnin shtetin e ri, ku edhe këndvështrimi i Serbisë do të dukej më bindës. Problemet që mund të ndodhin, në një rast të tillë, duke përfshirë me gjasë edhe largimin e serbëve nga territoret

në jug të lumit Ibër, mund të kenë efekte negative edhe në shtetet fqinjë.

Anashkalimi i Këshillit të Sigurimit do të përulte këtë institucion, çka do të shkaktoje pasoja negative për parandalimin e konflikteve në të ardhmen. Ky institucion nuk është shtet dhe me siguri së një anëtar i përhershëm siç është Rusia nuk do ta dëshironte përuljen e saj dhe rëndësia e saj për të ardhmen, eventualisht, mund të ndihmojë në afrimin e qëndrimeve për kalimin e një rezolute të kompromisit.

### III. NË KOSOVË

#### A. STRUKTURA E TRANZICIONIT

BE-ja ka dërguar dy ekiye në Kosovë, për të bërë planifikimin dhe për të krijuar bërthamën e prezencës së planifikuar për periudhën e pas statusit: ZNC-së- zyrës së Përfaqësuesit Ndërkombëtar- si dhe misionit vartës të tij për polici dhe gjyqësi. Duke pasur parasysh mungesën e kapaciteteve administrative vendore në Kosovë dhe kohën që nevojitet për dislokimin e këtij misioni ndërkombëtarë, çdo paqartësi për detajet praktike do ta bëjë të vështirë procesin e kalimit të përgjegjësive nga UNMIK-u te ZNC-ja dhe te Qeveria e Kosovës, për tre deri katër muaj sa është parashikuar, të periudhës së tranzicionit.<sup>59</sup> Ekipet e BE-së janë duke punuar në mënyrë shumë energjike dhe “kanë shumë besim”, vështroi një zyrtar i BE-së,<sup>60</sup> por janë të hendiçepuar nga shumë gjëra të panjohura dhe të papërcaktuara që kanë të bëjnë me statusin e Kosovës. Një zyrtar tjetër i BE-së, në Kosovë ka përshkruar gjendjen e tyre si “të tmerrshme”.<sup>61</sup> Kontura e propozimit të Ahtisaarit është e dukshme por përderisa të mos publikohet dhe të mbështetet nga komuniteti ndërkombëtar, diskutimet urgjentisht të nevojshme lokale nuk mund të jenë më tepër se sa teorike. Në Sekretariatit e OKB-së po bëhen krahasime me procesin e dobët të kalimit të kompetencave nga OKB-ja te policia e BE-së në Bosnjë, në fund të vitit 2002, që ndodhi në rrethana më të mira si rezultat i marrëveshjes dhe planifikimit më të hershëm.<sup>62</sup>

<sup>54</sup> Intervista të Grupit të Krizave, nëntor 2006.

<sup>55</sup> Vera në hemisferën jugore: shtator deri në dhjetor 2007.

<sup>56</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, nëntor 2006.

<sup>57</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, New York, 16 nëntor 2006.

<sup>58</sup> Intervista të Grupit të Krizave, New York, nëntor 2006.

<sup>59</sup> Kjo paraqet një argument të fituar nga planifikuesit e BE-së dhe nga SHBA-te. Sekretariati i OKB-së donte një tranzicion më të gjatë dhe ende shpreson që ky proces praktikisht të zgjatë më shumë se katër muaj. Intervistë e Grupit të Krizave, Sekretariati i BE-së, nëntor 2006.

<sup>60</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, nëntor 2006.

<sup>61</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, tetor 2006.

<sup>62</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, nëntor 2006. Zyrtarë të OKB-së, në mënyrë jo mjaft të drejtë, fajësojnë BE-në për problemet. Shih Raportin e Grupit të Krizave për Evropë nr



BE-ja nuk është mjaft transparente për përgatitjet e saj. Pjesërisht, kjo bëhet për të ruajtur opsionin për tërheqje në rast se nuk e merr përkrahjen e duhur nga ana e Këshillit të Sigurimit.<sup>63</sup> Por kjo mund ta bëjë edhe më të vështirë sigurimin e përkrahjes që misionit të saj do t'i nevojitet për vendimmarrje dhe për vendosje të suksesshme të resurseve të saj, në Kosovë. Kjo po ashtu mundëson që pikëpamjet disidente brenda BE-së të marrin më shumë vëmendje se sa që e meritojnë, në Këshillin e Sigurimit, i cili po e injoron progresin substancial të bërë nga ana e Brukselit. Një zyrtar i BE-së ka shprehur bindjen se një tranzicion i rregullt do të jetë i suksesshëm, vetëm për arsye se “të gjitha opsionet e tjera janë katastrofale ... Shpresoj se qasja realiste dhe përgjegjësia do të mbizotërojë në radhët e komunitetit ndërkombëtar”.<sup>64</sup>

Shtyrja e zgjidhjes së statusit do të krijojë probleme për tranzicionin UNMIK-ZNC. ZNC pretendon të dërgojë dhe vendos pjesën më të madhe të strukturës së saj vetëm pasi që të ketë vepruar Këshilli i Sigurimit.<sup>65</sup> Në ndërkohë, megjithatë, në pritje të përfundimit të administrimit të OKB-së, stafi me eksperiencë i UNMIK-ut kanë filluar të gjejnë vende të reja të punës, një problem që mund të shkaktojë shumë kokëçarje që nga janari 2007.<sup>66</sup> Sa më shumë që të prolongohet procesi, aq më shumë do të zvogëlohet numri i stafit ndërkombëtar të kualifikuar dhe aq më shumë do të zgjatë procesi i tranzicionit, pavarësisht nga vazhdimi i përgjegjësive formale të UNMIK-ut.<sup>67</sup> Për më tepër, sa më tej që të shtyhet procesi për në vitin 2007, aq më pak mund të presim që të kenë durim shoqëria kosovare dhe liderët e saj.

OKB-ja dhe BE-ja ende nuk po mund të përballen sy më sy dhe të vendosin se si do të menaxhojnë tranzicionin që do të pasojë pas vendimit të Këshillit të Sigurimit. OKB-ja e sheh detyrën e saj për përfundimin e UNMIK-ut si një mision kompleks, që kërkon përkrahje të madhe

nga brenda.<sup>68</sup> Planifikuesit e BE-së po përshpejtojnë planet për caktimin dhe dërgimin e Përfaqësuesit të Bashkësisë Ndërkombëtare, menjëherë pas marrjes së mandatit nga Këshilli i Sigurimit. Peter Feith, me përvojë në Ballkan, momentalisht Përfaqësues Special i BE-së në Aceh (Açeh), pritet të marrë këtë detyrë. Një ZNC me mandat të freskët, me energji të re dhe me një lider të fortë, do të jetë organizatë që do të mund të këshillojë qeverinë e Kosovës, gjatë këtyre muajve. Sigurisht se kjo e fundit do t'i kushtojë më pak vëmendje UNMIK-ut në largim.<sup>69</sup>

UNMIK-u, me autoritetin e tij para përfundim, po u bën thirrje shqiptarëve të Kosovës që për interesin e tyre të përmbahen nga kërcënimet me dhunë. Policia e UNMIK-ut ka paralajmëruar me anë të një deklarate për shtyp, më 27 nëntor, se “procesi i statusit është në një fazë kritike, dhe bota i ka sytë kah Kosova, çdo veprim i dhunshëm vetëm do të kthente orën mbrapa për Kosovën”.<sup>70</sup> Në një takim të mbajtur në hollin e qytetit në Drenas, më 5 dhjetor, Përfaqësuesi Special Rucker është raportuar të ketë thënë se shfaqja e dhunës në rast se zgjidhja e statusit shtyhet prapë, në vitin 2007, vetëm se do t'i ndihmonte Beogradit.<sup>71</sup> Në të njëjtën kohë, UNMIK-u u tregua i përmbajtur dhe nuk reagoi ashpër kundër demonstruesve të cilët sulmuan selinë qendrore të UNMIK-ut me shishe me ngjyrë dhe me gurë më 28 nëntor.<sup>72</sup>

Dështimi i Ruckerit për të ndërtuar autoritet personal me publikun<sup>73</sup> është kompensuar nga zëvendës i tij energjik,

164, Reformat e Ngecura në Polici në Bosnjë: *Nëse nuk ka Përparim, Nuk ka as BE*, 6 shtator 2005; dhe nr.130, Udhëqeqja me Policinë në Bosnjë: *Agjenda për Reforma të Mëutjeshme* 10 maj 2002.

<sup>63</sup> Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të BE-së, dhjetor 2006.

<sup>64</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 28 nëntor 2006.

<sup>65</sup> Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të BE-së, 28 nëntor 2006.

<sup>66</sup> Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të OKB-së, 16 nëntor 2006.

<sup>67</sup> Departamenti për Operacione Paqeruajtëse i OKB-së ka kërkuar për shpenzime të paplanifikuara një buxhet për të vazhduar veprimtarinë e UNMIK-ut në vitin fiskal korrik 2007-qershor 2008. Intervistë e Grupit të Krizave, New York, 13 nëntor 2006.

<sup>68</sup> Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të OKB-së, 13 nëntor 2006.

<sup>69</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, New York, 13 nëntor 2006.

<sup>70</sup> Kjo vazhdoi: “Të sulmohet personelin apo pronën e UNMIK-ut është destruktive dhe kontraproduktive, posaçërisht në këtë periudhë kohore”.

<sup>71</sup> Fatmir Aliu dhe Xhemë Binaku, “Ruecker: Dhuna e kthen Kosovën nën Beograd” [Rucker: Violence puts Kosovo back under Belgrade], *Koha Ditore*, 6 dhjetor 2006.

<sup>72</sup> Lëvizja “Vetëvendosje” e Albin Kurtit ka mobilizuar përafërsisht 3.000 protestues në Ditën e Flamurit Shqiptar, numër ky që në masë të konsiderueshme tejkalon numrin e pjesëmarrësve në demonstrata në vitin 2006 por ende përkrahja për këtë lëvizje konsiderohet e vogël. Edhe pse Kurti insistoi se protesta ishte “jo e dhunshme”, sulmi ndaj ndërtesave ishte plan kryesor dhe mirë i përgatitur i protestës. UNMIK-u nuk rezistoi ndaj dëmtimit të zyrave qendrore të saj derisa nuk u gjuajt një mjet nxitës dhe policia reagoi me gaz lotsjellës. Disa protestues që ishin më aktiv në gjuajtjen e e ngjyrës dhe gurëve u arrestuan, por jo edhe Kurti.

<sup>73</sup> Sondazhi i Raportit për Paralajmërim të Hershëm i USAID/UNDP-së për tremujorin e tretë të vitit 2006, i cili do të publikohet para fundit të vitit, tregon për një rënie të dukshme të besueshmërisë ndaj PSSP-së ndërmjet muajve qershor dhe shtator, nga rreth 70 për qind në 35 për qind.

Steven Schook, një ish gjeneral i SHBA-ve, i cili dëshiron të udhëheqë me çështjen e sigurisë. Megjithatë, NATO dhe KFOR-i kanë kundërshtuar tendencat e tij për përfshirjen e tyre në planin e tij për mbajtjen e sigurisë në veriun serb të Kosovës, gjatë periudhës së përcaktimit të statusit, të cilët konsiderojnë se bregat e tij për sigurinë atje, janë të stërmadhuara dhe qëllimet e tij si shumë politike.<sup>74</sup> Në të vërtetë, bashkëpunimi KFOR-UNMIK është zvogëluar që nga koha që këto dy institucione udhëhiqeshin nga PSSP Jessen-Petersen dhe nga Komandanti i KFOR-it de Kermabon në periudhën shtator 2004 - gusht 2005. NATO insiston që prezenca e saj e vazhdueshme ndërkombëtare në Kosovë do të veprojë e pavarur nga Përfaqësuesi i Komunitetit Ndërkombëtar (PKN);<sup>75</sup> pra nuk do të ketë unifikim të komandës civile dhe asaj ushtarake nën një zyrtar siç është rasti me UNTAES-in.<sup>76</sup>

Gjatë periudhës së tranzicionit, misioni për sundimin e ligjit i BE-së është krijimi i kapaciteteve të plota, duke përfshirë me gjasë edhe vendosjen e një kontingjenti të xhandarmërisë në veri,<sup>77</sup> ndërsa institucionet kosovare duhet të përgatiten për të marrë kompetencat nga UNMIK-u dhe për fillimin e implementimit të detyrave të tyre që dalin nga marrëveshja për statusin. Në detyrat e kësaj të fundit përfshihet edhe miratimi i një kushtetute që reflekton kënaqshëm, për ZNC-në, aplikimin e kushteve dhe ligjeve të përcaktuara sipas marrëveshjes së statusit, që kanë të bëjnë me ligjet kryesore për implementimin e decentralizimit dhe të mbrojtjes së Kishave Ortodokse Serbe dhe territoreve përreth tyre.

Ekipi planifikues i ZNC-së, që kur është dërguar zyrtarisht, në tetor 2006 në Prishtinë, i ka përcaktuar vetes një agjendë jo vetëm krijimin e strukturës së vet, por edhe për ta përgatitur qeverinë e Kosovës: “Administrativisht dhe politikisht kjo sfidë e dyfishtë tejkalon gjithçka që Kosova ka menaxhuar në të kaluarën”.<sup>78</sup> Por shoqëria shqiptare e Kosovës është tejet

e shqetësuar me planet për strukturën mbikëqyrëse të komunitetit ndërkombëtar.<sup>79</sup> Liderëve të saj i mungon vizioni dhe institucionet e tyre janë pasive, të cilët shumë shpesh mbështeten vetëm në iniciativat e partnerëve të tyre ndërkombëtar dhe me gjasë mirëpresin prospektet e ardhjes së një shefi të ri.<sup>80</sup>

Për më tepër, qeveria e tanishme është një themel i dobët për të shërbyer për ndërtime të mëtejme mbi të. Partia më e madhe e koalicionit, LDK-ja, është paralizuar nga zgjedhjet brenda partisë. Tensioni ndërmjet dy krahëve përafërsisht të barabartë të saj ka shpërthyer në një grindje mes tyre në kuvendin zgjedhor të partisë, më 9 dhjetor. Ramush Haradinaj, udhëheqësi i partisë dukshëm më të vogël të koalicionit, AAK-së, i cili nga prapaskena ofron mbështetjen më të madhe për udhëheqësinë e këtij koalicioni, pas Vitit të Ri do të shkojë në Hagë ku do të gjykohet për krime të luftës. Kryeministri Agim Çeku, ka kapacitet të kufizuar për të koordinuar kabinetin, megjithëqë, ai ka një orar të ngjeshur me udhëtime jashtë vendit për lobim për çështjen e Kosovës. Gjatë viteve 2005-2006 ka pasur mjaft largime të stafit të kualifikuar.<sup>81</sup> Aftësia për menaxhimin e krizave është minimale; ministri i ri i punëve të brendshme ka qenë i ngathët deri më tani.

Planifikuesit e ZNC-së kanë riformuar dhe kanë rimëkëmbur konsultimet e dobëta të UNMIK-ut për transferimin e kompetencave. Një Grup Strategjik për Tranzicionin, i krijuar në nëntor 2006, i bashkë udhëhequr nga ekipi i ZNC-së, PSSP-ja ose zëvendësi i tij dhe nga udhëheqësja e zyrës ndërlidhëse diplomatike të SHBA-ve, ka propozuar krijimin e shtatë grupeve punuese: për kushtetutën, zgjedhjet, administratën civile, ekonomi, qeverisjen, sundimin e ligjit dhe tranzicionin ligjor. Të tre bashkudhëheqësit përkrahin përsheptimin e përgatitjeve për transferimin e kompetencave të qeveria e Kosovës (IPVQ), edhe pse këshilltari ligjor i UNMIK-ut tregohet mjaft i përmbajtur dhe së paku një vend i madh i BE-së duket që favorizon një dorëzim më të ngadalshëm të kompetencave.<sup>82</sup>

Shumica e përfaqësuesve të Kosovës vinë nga qeveria por edhe anëtarët e Grupit Politik dhe Strategjik të Ekipit të Unitetit, të cilët përfaqësojnë nivelin e mesëm

Soren Jessen Petersen dha dorëheqje më 30 qershor; Joachim Rucker morri postin më 14 gusht.

Shih <http://www.kosovo.undp.org/>.

<sup>74</sup> Për më shumë, shih Raportin e Grupit të Krizave, Statusi i Kosovës [*Kosovo Status*], op. cit., f. 20.

<sup>75</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Bruksel, 10 nëntor 2006.

<sup>76</sup> Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara për Sllavoninë Lindore (UNTAES), e cila mbikëqyri riintegrimin e territorit në shtetin Kroat, ishte temë shqyrtimi në raportin e parë të Grupit të Krizave, Sllavonia Lindore [*Eastern Slavonia*], 27 mars 1996.

<sup>77</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, dhjetor 2006.

<sup>78</sup> Torbjorn Sohlstrom, përfaqësuesi personal i Solanës dhe udhëheqës i Ekipit Përgatitor të Zyrës së Përfaqësuesit Special Evropian për Kosovë/Komunitet Ndërkombëtar, i drejtohet konferencës së Forumit 2015 “Mbikqyrja e Ardhsme Ndërkombëtare në Kosovë”, 14 dhjetor 2006.

<sup>79</sup> Sohlstrom tha se gjatë tri javëve të mëhershme ka numëruar 37 artikuj në shtypin shqiptar të Kosovës ku është shkruar për detyrat dhe kompetencat e prezencës ndërkombëtare pas statusit dhe vetëm një rreth asaj se çka do të bëjnë institucionet kosovare pas statusit.

<sup>80</sup> Intervista dhe vrojtime të Grupit të Krizave, Prishtinë, nëntor-dhjetor 2006.

<sup>81</sup> Intervistë e Grupit të Krizave me zyrtar të lartë të UNMIK-ut, Prishtinë, 11 dhjetor 2006.

<sup>82</sup> Intervista të Grupit të Krizave me politikanë dhe zyrtarë të IPVQ-së, Prishtinë, dhjetor, 2006.

politik në partitë e tyre, janë të përfshirë në te, në mënyrë që të krijohet një bazë më e gjerë politike.<sup>83</sup> Anëtarët nga opozita ndiheshin se po kërkohej nga ta të bënin punë të vogla të natyrës teknike që ishin obligim i qeverisë, vetëm për të siguruar konsensus dhe ishin të indinjuar nga fakti se po vepronin pa mandat specifik nga Ekipi i Unitetit. Ky trup nuk u takua për një muaj që nga shpallja e vendimit të Ahtisaarit për shtyrjen e zgjidhjes së statusit.<sup>84</sup> Por, u rivalizua disa ditë pas fitores së Presidentit Sejdiu në kuvendin zgjedhor të LDK-së, kur në takimin e ardhshëm miratoi Grupin Strategjik për Tranzicion dhe u pajtua për krijimin e dy grupeve punuese të përbashkëta qeveri/opozitë (për kushtetutën dhe për zgjedhjet).

Suksesi i IPVQ-së në zbatimin e agjendës administrative dhe legjislativë gjatë periudhës së tranzicionit do të ketë efekt të madh në interpretimin e zgjidhjes për statusin, si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës. Pa marrë parasysh dispozitat e mbikëqyrjes nga ZNC-ja dhe kompetencat e rezervuara për te, marrëveshja do të jetë një ftesë për qeverinë e Kosovës për të treguar aftësitë e saj. A do ta shohë edhe ajo këtë si diçka të tillë apo si një akt të nënshkrimit për kalimin e administrimit ligjor ndërkombëtar për një shtet të dështuar nga OKB-ja të BE-ja.?

Gjithashtu, qeveria dhe Kuvendi mund të provojnë ta bëjnë decentralizimin të suksesshëm në mënyrë që të fitojnë besimin e serbëve të Kosovës. Megjithatë, qasja e tyre është e kontrolluar, duke bashkë menduar apo së paku duke mos dashur që haptazi ta sfidojnë besimin që e ndajnë shumica e shqiptarëve të Kosovës se ata do të jenë në gjendje të modifikojnë kufijtë e komunave të reja ose të atyre të zgjeruara me shumicë serbe në lindje të Kosovës, që do të mund të krijohen dhe përcaktohen me marrëveshjen për statusin. Së paku, do të ngurrojnë në implementimin e prerogativave të decentralizimit derisa Serbia ta njohë Kosovën,<sup>85</sup> apo nëse shihet se komuniteti ndërkombëtar po e humb kontrollin në tri komunat serbe në veri të Ibrit dhe një të re në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës.<sup>86</sup> Shumë politikanë shqiptarë të Kosovës thonë se ata u kanë ofruar serbëve decentralizimin në lindje të Kosovës me kusht që të sigurojnë se veriu serb të mbetet në Kosovë.<sup>87</sup> E tëra kjo

mund të nënkuptojë se shteti i ri në muajt e parë do të përjetojë një garë ndërmjet qëndrimeve dhe dëshirave të autoriteteve të tij dhe atyre të ZNC-së.

## B. KOHEZIONI POLITIK DHE SOCIAL

Njoftimi i Ahtisaarit, më 10 nëntor 2006 për mos shpalljen e propozimit të tij deri pas zgjedhjeve në Serbi, është pranuar në mënyrë të qetë në Kosovë. Ekipi i Unitetit, atë ditë u takua me Tina Kaidanov, udhëheqësen e zyrës diplomatike të SHBA-ve, në Kosovë, dhe publikoi një deklaratë ku shprehu dëshpërimin e vet për vendimin por duke e pranuar atë.<sup>88</sup> Sidoqoftë, shtyrja i ka dëmtuar politikanët kryesorë të Kosovës, të cilët tani duken naivë, nëse jo qesharak, që kanë insistuar për një kohë aq të gjatë se vendimi për statusin do të merret brenda vitit 2006. Kredibiliteti i tyre është dobësuar, ata do ta kenë edhe më të vështirë për të arsyetuar ndonjë shtyrje të re.

Në Kosovë është krijuar bindja se do të jetë e vështirë të menaxhohet shtyrja më gjatë disa muaj. Duke rikujtuar mospajtimin e shumicës me hedhjen e gurëve dhe të shisheve me ngjyrë mbi selinë e UNMIK-ut dhe të IPVQ-ve, nga ana e lëvizjes Vetëvendosje të Albin Kurtit, më 28 nëntor, një zyrtar i komunës shtoi: “Deri në mars do të mendoj njëjtë si tani, por nuk e di se çka do të mendoj pas marsit”.<sup>89</sup> Anëtarët e Kuvendit nga spektri i gjerë politik shqiptar besojnë se zemërimi që buron nga populli, i drejtuar pjesërisht kundër liderëve të Kosovës, do të jetë vështirë për ta kontrolluar politikisht, dhe veprimet për pavarësi të njëanshme do të arsyetoheshin në rast se komuniteti ndërkombëtar nuk do ta ofroj atë më herët.<sup>90</sup>

Shumë shqiptarë të Kosovës, çdo shtyrje të mëtutjeshme do ta interpretojnë si konfirmim të faktit se forcat pro-pavarësisë po humbi teren. Sa më gjatë që të shtyhet zgjidhja e statusit, aq më shumë do të zvogëlohet besimi në vlerat e bashkëpunimit me bashkësinë ndërkombëtare.<sup>91</sup> Megjithatë, shumica e kanë parasysh

<sup>83</sup> Shih Raportin e Grupit të Krizave, Statusi i Kosovës, op. cit., f. 12 për informata për Ekopin e Unitetit dhe trupat e tij vartës.

<sup>84</sup> Intervista të Grupit të Krizave me politikanë qeveritarë dhe opozitarë, Prishtinë, 7-13 dhjetor 2006.

<sup>85</sup> Intervista të Grupit të Krizave, Prishtinë, Gjilan, Viti, nëntor-dhjetor 2006.

<sup>86</sup> Shih Raportin e Grupit të Krizave për Europë Nr.165, *Bashkim të Mitrovicës, Jo Ndarje të Kosovës*, 13 shtator 2005, dhe Raportin, *Statusi i Kosovës*, op. cit., f. 19-23, për informata për këtë territor të dominuar nga serbët.

<sup>87</sup> Intervista të Grupit të Krizave, Prishtinë, 5-11 dhjetor 2006.

<sup>88</sup> Në mënyrë koincidente, emisioni televiziv i RTK-së dhe BIRN-it, *Jeta në Kosovë*, transmetoi atë mbrëmje intervista me të dërguarin amerikan Frank Wisner, ish sekretarin e shtetit Richard Holbrooke dhe udhëheqësin e Zyres Ndërlidhëse Franceze në Prishtinë Thierry Reynard, të cilat përmbanin mesazhe rikonfirmuese.

<sup>89</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Viti, 30 nëntor 2006.

<sup>90</sup> Intervista të Grupit të Krizave, Prishtinë, nëntor 2006.

<sup>91</sup> Intervista të Grupit të Krizave me anëtarë të Parlamentit, Prishtinë, nëntor 2006. Një ish komandant i UÇK-së me influencë ka sugjeruar se sjellja e shqiptarëve të Kosovës mund të ndryshoj papritur nëse humbet besimi: “Përderisa besojmë në proces ne duhet të ruajmë dhe t’i kontribuojmë stabilitetit. Përndryshe, nëse shohim se beteja për pavarësi po humbet,

se procesi me gjasë do të zgjasë më gjatë dhe se institucionet e Kosovës kanë mbetur mbrapa me përgatitjet e tyre për pavarësi. Përkrahja që NATO-ja i ka ofruar Kosovës kohëve të fundit për krijimin e një force vetanake të sigurisë ka qenë një ringjallje e besimit,<sup>92</sup> edhe reagimi ndaj ftesës së NATO-s bërë Serbisë, për të ju bashkuar Partneritet për Paqe (PfP), çuditërisht ka qenë pozitiv.<sup>93</sup> Mundësitë për të zhvilluar dhe mirëmbajtur një proces të rregullt edhe pas marsit do të jenë relativisht të mëdha në qoftë se pakoja e Ahtisaarit do të pranohet dhe do të trajtohet mirë, sidomos në New York, dhe, normalisht, varësisht nga dispozitat substanciale që do të përmbajë kjo pako. Ka mundësi që SHBA-të dhe diplomatët të tjerë perëndimorë të shtyjnë të dërguarin special që të forcojë disa nga elementet e pavarësisë në pako, si kompensim për shtyrjen. Së paku, një përshtypje të tillë po mundohen ta lënë te politikanët shqiptarë të Kosovës. Ata po i inkurajojnë politikanët shqiptarë të përgatisin trupat e reja qeveritare si Ministrinë e Punëve të Jashtme.<sup>94</sup>

Interesi i qeverisë dhe opozitës për arritjen e koncenzusit për punët për statusin është rritur, edhe pse deri para mbajtjes së kuvendit zgjedhor të LDK-së më 9 dhjetor, bëheshin lojëra politike me këtë çështje. Pas shpalljes së vendimit, që bëri Ahtisaari mori për shtyrjen e statusit, partitë opozitare propozuan që roli i Ekipit të Unitetit të zgjerohet dhe të përfshijë edhe marrjen e vendimeve për kushtetutën e ardhshme, simbolet shtetërore, përcaktimin e kohës dhe rregullave për zgjedhjet si dhe për përgatitjet e qeverisë për të pranuar kompetencat shtetërore. Koalicioni qeverisës e kundërshtoi këtë duke e cilësuar si cenim të mandatit të tyre dhe si hap të parë drejt një qeverie gjithëpërfshirëse. Disa nga përfaqësuesit e saj kanë thënë

---

duhet të veprojmë”, Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 8 dhjetor 2006.

<sup>92</sup> Koncenzusi i NATO-s për mbështetjen e idesë së Ahtisaarit për një forcë të sigurisë se Kosovës prej 2500 trupash u bë i qarte në tetor 2006. Augustin Palokaj, “Ushtri me 2500 ushtarë për Kosovën”, *Koha Ditore*, 21 tetor 2006. Për më tepër, shih Raportin e Grupit të Krizave Nr. 174, *Një Ushtri për Kosovën?* 28 korrik 2006.

<sup>93</sup> Kryeministri Çeku përshëndeti publikisht vendimin. Intervista të Grupit të Krizave me politikanë të lartë të PDK-së dhe me Daut Haradinajn, Prishtinë, dhe me grupe qytetarësh, Prishtinë dhe Viti, 30 nëntor-8 dhjetor 2006, të cilët poshtu reagan pozitivist.

<sup>94</sup> Intervista të Grupit të Krizave me zyrtarë dhe politikanë të IPVQ-ve, Prishtinë, dhjetor 2006. Një pretendim në gazetën *Express* më 8 dhjetor ku shkruhej se Ahtisaari i ka ftuar politikanët kosovarë në Vjenë, në muajin dhjetor, për shikimin paraprak të paketës, doli se ishte i zmadhuar, por megjasë, diplomatët mund t'i ofrojnë grupit punues për kushtetutën e Kosovës të mandatuar nga Ekipi i Unitetit pjesë të pakos për t'i përdorur si udhërrëfyes.

se roli i Ekipit të Unitetit është përmbyllur me përfundimin e negociatave të Vjenës dhe se gjërat e tilla duhet të trajtohen nga Qeveria dhe Parlamenti.

Megjithatë, nuk ka asnjë alternativë praktike për Ekipin e Unitetit; tendencat për ta risajuar do të ishin humbje e kohës dhe shpenzim i energjisë dhe, si rezultat më i mirë i mundshëm do të ishte krijimi i një ekipi të ngjashëm. Për më tepër, koncenzusi politik kërkon të ketë një agjendë të punës në mënyrë që të zhvillohet dhe të jet solid. Ekipi i Unitetit dhe Grupi vartës i tij Politik dhe Strategjik kanë stagnuar pas shpalljes për shtyrjen e statusit, nga Ahtisaari, duke lejuar të dalin në qendër të vëmendjes zëra të pakoordinuar. Pas sjelljes së Grupi Politik dhe Strategjik në procesin e planifikimit të tranzicionit, këta duhet të rifuqizohen dhe të inkurajohen. Çështjet e hapura, siç janë kushtetuta e re, zgjedhjet dhe hapja e zyrave përfaqësuese të Kosovës jashtë kërkojnë vëmendje të posaçme.<sup>95</sup> Riangazhimi i politikanëve të nivelit të mesëm nga opozita dhe qeveria mund të rezultojë me krijimin e bazave të reja për një koncenzus të mëtutjeshëm politik për çështjet e statusit në vitin potencial për trazira, 2007.<sup>96</sup>

Ngjarjet në LDK kanë ndikim të madh në përgatitjet për statusin. Si forcë dominuese politike gjatë gjashtëmbëdhjetë viteve të fundit, LDK-ja në një masë të madhe përfaqëson Kosovën, por skenat në kuvendin e saj zgjedhor, u paraqitën elemente karakteristike të armiqësive ndër-shqiptare, treguan shumë për limitet e kulturës politike të këtij vendi dhe. Rivaliteti i egër PDK-LDK i viteve të hershme të pasluftës, tani në një masë të madhe është qetësuar,<sup>97</sup> përderisa kontingjente të mëdha të truprojave më 9 dhjetor treguan se vet LDK-ja është shndërruar në fushëbetëjën kryesore për politikë të dhunshme dhe përçarëse.

Edhe pse Presidenti Sejdiu e fitoi udhëheqjen e LDK-së në mënyrë të drejtë me votë të fshehtë (me 189 vota ndaj rivalit të tij Daci i cili fitoi 160 vota), kuvendi u përça më vonë gjatë ditës, për zgjedhjen e 81 anëtarëve për

---

<sup>95</sup> Politikanët e opozitës i kundërshtuan planet e shpallura më 24 nëntor 2006 për hapjen e një zyre të tillë në Bruksel e me gjasë edhe në Washington, nën udhëheqjen e zyrtarëve të UNMIK-ut. “UNMIK-u zyrtarizon hapjen e zyrave ndërlidhëse jashtë Kosovës” [UNMIK-u autorizon hapjen e zyrave ndërlidhëse jashtë vendit], *Koha Ditore*, 25 nëntor 2006.

<sup>96</sup> Një personalitet qeveritar ka shprehur frikën se një politikë elektorale e ndryshme nga kjo e tashmja do të dominojë menjëherë pas vendimit për statusin, çka do ta largonte vëmendjen e liderëve nga implementimi i obligimeve të përcaktuara sipas statusit. Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 11 dhjetor 2006.

<sup>97</sup> Për më shumë informata shih Raportin e Grupit të Krizave Nr.163, *Kosova pas Haradinajt*, 26 maj 2005.

Këshillin e Përgjithshëm. Kjo trupë zgjedh udhëheqësin kryesor të partisë, detyrë kjo me rëndësi të posaçme, sepse Sejdiu, i cili në bazë të Kornizës Kushtetuese të UNMIK-ut nuk mund të mbajë postin e Kryetarit të Kosovës dhe të mbajë edhe një post tjetër njëkohësisht, sipas të gjitha gjasave do t'ua lejë të tjerëve të udhëheqin partinë.

Me fitoren e zgjedhjeve për udhëheqjen e partisë me rezultat më të ngushtë se që ishte pritur dhe duke qenë i pasigurt për kalimin e listës së tij për Këshillin e Përgjithshëm, i cili sipas rregullave kërkohej të votohej me votim të fshehtë, Sejdiu tentoi që të bëjë aprovimin e listës me kandidatët e tij me aklamacion, bile duke urdhëruar edhe mbylljen e detyrës, në mënyrë që të sigurojë kuorumin e duhur brenda sallës. Kur ai kundërshtoi kërkesat për shtyrje të Kuvendit, disa përkrahës të Dacit vendosën që ta përçajnë kuvendin atë mbrëmje, gjë që mandej shkaktoi kaos, rrahje me grushte dhe hedhje karrigesh. Kampi i Sejdiut deklaroi se janë mbledhur numër i mjaftueshëm i delegatëve për të aprovuar listën e tij për Këshill të Përgjithshëm. Daci dhe përkrahësit e tij refuzuan t'i njohin këto rezultate, dhe tërheqja e tyre vazhdon, të cilët po kërcënojnë me themelimin e një partie alternative nëse grupi i tyre nuk përfshihet proporcionalisht në Këshillin e Përgjithshëm, sipas votave të marra në kuvendin zgjedhor. Në ndërkohë, më 19 dhjetor, Këshilli i Përgjithshëm i kontrolluar nga Sejdiu, ka zgjedhur një grup zyrtarësh partiak, lojal ndaj Sejdiut.

Brenda një kohe të shkurtë, mbështetja e Sejdiut në Zyrën Diplomatike të SHBA-ve dhe të UNMIK-u, për ndihmë kundër Dacit, ka krijuar mundësi më të mëdha që komuniteti ndërkombëtar dhe partitë opozitare të vazhdojnë punën për statusin përmes Ekipit të Unitetit dhe vartësitet e tyre. Disa faktorë do të mund të angazhohen për një zgjerim të koalicionit në vitin e ri. Komuniteti ndërkombëtar do t'i konsideronte krahun e Sejdiut të LDK-së dhe PDK-në e Thaçit si partnerë më të besueshëm në krahasim me koalicionin e tanishëm LDK-AAK. Thaçi u duk se paraqiti një uverturë të koalicionit përmes deklaratës së tij të bërë në kuvendin e LDK-së, një deklaratë që nuk do të mund as të imagjinohej në kohën e liderit të LDK-së, Rugova.

Në një plan afatgjatë, përkrahja që zyra e SHBA-ve i ka ofruar Sejdiut më 10 dhjetor mund të dëmtojë reputacionin e komunitetit ndërkombëtar për paanshmëri.<sup>98</sup> Është e vështirë të argumentohet se

<sup>98</sup> Shih deklaratën për shtyp të Zyrës Amerikane, "Për zgjedhjet në LDK", 10 dhjetor 2006, e cila mund të gjendet në: <http://pristina.usmission.gov/>. Shefja e zyrës Tina Kaidanow takoi Sejdiun më 10 dhjetor. Mbështetje pa rezervë e saj për zgjedhjen e Fatmir Sejdiut, ka bërë që të mos bëhen

Këshilli i Përgjithshëm është zgjedhur në mënyrë legjitime. Përkrahësit e Sejdiut mund të arsyetohen se ka qenë e domosdoshme të bëhen disa shkurtime të procedurave, në mënyrë që të goditen interesat e ndryshme, disa prej tyre edhe kriminale, që qëndrojnë prapa Dacit, dhe në mënyrë që t'i epet shansi partisë që të rivalizohet. Por, Këshilli i ri i Përgjithshëm nuk mund të jetë më shumë se sa një trupë e kontrolluar nga një grup njerëzish, dhe abuzimi procedural që u bë për zgjedhjen e tij mund të shndërrohet në një kulturë fatkeqe të veprimit politik në parti dhe qeveri.

Furnizimi me energji këtë dimër ka mundësi të jetë më i vështirë se zakonisht. Veç tani po ndodhin ndërprerje të gjata, edhe pse është minuar linjiti i cili është i pamjaftueshëm për mbajtjen e prodhimit në kapacitet të plotë. Për më tepër, situata në tregun rajonal të energjisë elektrike është mjaft e vështirë si rezultat i mbylljes së kapaciteteve nukleare në Bullgari (që ishte kusht për hyrjen e Bullgarisë në BE, më 1 janar). Kur kompania e energjisë, KEK në shkurt 2006, ndërpreu përkohësisht aplikimin e skemës ABC të reduktimeve, sipas së cilës favorizoheshin lagjet që paguanin më shumë për energjinë e shpenzuar, qytetarët që përjetuan ndërprerje të gjata të energjisë në temperatura të ulëta klimatike, rrethuan zyrat regionale dhe shkatërruan paisjet transmetuese të energjisë.<sup>99</sup> Skema ABC i ka mundësuar KEK-ut realizim 15 për qind më të lartë të mbledhjes së borxheve këtë vit, por pakënaqësia është rritur edhe më shumë për shkak të shkrimeve në media në lidhje me pagat e larta, të cilat i marrin anëtarët vendor të stafit menaxherial të kompanisë.

Çdo dimër gjatë viteve të fundit, Serbia e ka akuzuar UNMIK-un që po lejon që enklavat serbe të Kosovës të bëhen pjesë e "katastrofës humanitare" të ndërprerjeve të gjata të energjisë elektrike.<sup>100</sup> Me aplikimin e skemës ABC, KEK-u i ka furnizuar ata me rrymë në mënyrë të kufizuar, dhe kjo është bërë me arsyen se këto enklava, të inkurajuar nga Beogradi, kanë refuzuar të nënshkruajnë kontratat konsumatorësh dhe të paguajnë fatura, dhe jo me qëllime diskriminuese. Përkundër kundërshtimit të qeverisë dhe të KEK-ut, dhe nën presionin e madh të Grupit të Kontaktit për të arritur një marrëveshje, UNMIK-u është duke negociuar me

vlerësime më të thella nga organizatat, siç është OSBE-ja të cilët ndryshe do të kishin ngritur qeshjen e validitetit të zgjedhjes së Këshillit të Përgjithshëm.

<sup>99</sup> Shih "Qytetarët hyjnë me dhunë në ndërtesat e distribucionit të KEK-ut dhe kërkojnë energji elektrike", *Zëri*, 31 janar 2006.

<sup>100</sup> Zëdhënësjja serbe, Sanda Raskovic-Ivic, bëri të njëjtën prapë në takimin për raportimin tremujor në Këshillin e Sigurimit, të mbajtur më 13 dhjetor, duke thënë se ndërprerjet e rrymës për komunitetin serb janë "drastike dhe në mënyrë selektive", pa dashur të dijë se edhe komuniteti shqiptar po ballafaqohet me ndërprerje të njejta të rrymës.

qeverinë e Serbisë lidhur me ofertën e qeverisë serbe për furnizimin me 50 gigavat të energjisë elektrike, në muajt të më shumë se 40,000 familjeve serbe të Kosovës. Kjo do ngriste nivelin e përgjithshëm të furnizimit të Kosovës me energji për 10 për qind gjatë këtij dimri por në anën tjetër do të rrezikonte në nxitjen e reagimeve nga ana e shqiptarëve për shkak të privilegjit që do tu bëhet serbëve, të cilët nuk kanë paguar asnjë faturë gjatë shtatë viteve të fundit, si dhe i mundëson furnizuesit të energjisë elektrike nga shteti serb, EPS, të ndaj territoret serbe nga rrjeti i KEK-ut. UNMIK-u insiston se serbët e Kosovës duhet të nënshkruajnë kontrata konsumatorësh me KEK-un, ndërsa pagesa kolektive e shpenzimeve të bëhet nga Serbia. Duket që qeveria e Serbisë të jet afër rritjes së një marrëveshje për ofrimin e asistencës në të holla.<sup>101</sup>

Dimri pa energji elektrike dhe përshtypja se serbët po përfitojnë një trajtim të veçantë, do të ishte një kombinim i rrezikshëm, i ngjashëm me atë që nxitit trazirat e marsit 2004. Kushtetuta e re e Serbisë, zgjatja e procesit të statusit dhe deklaratimet eksplicite që sa vijnë bëhen më të zëshme të Rusisë për përdorimin e vetos, te disa serb të Kosovës ka ringjallur shpresën se pavarësia mund të shmanget.<sup>102</sup> Me proklamimet nga ana e Vetëvendosjes se komunat e reja me shumicë serbe do të bëhen territore ku shqiptarët nuk do të kenë qasje, është jashtëzakonisht e rëndësishme që propozimet e Ahtisaarit për decentralizimin të bëhen qartë në kontekst të pavarësisë së Kosovës.

Me gjasë, sfida më e madhe për shqiptarët gjatë muajve të ardhshëm do të jetë rezistimi ndaj provokimeve për dhunë në Mitrovicë, ku tensionet janë të larta. Liderët serb të Kosovës atje, Marko Jakšiq dhe Milan Ivanović, duket se do të sillen me mospërfillje në mënyrë provokative ndaj Prishtinës dhe komunitetit ndërkombëtar, dhe nuk brengosen shumë për pasojat e mundshme për komunitetin serb në jug të lumit Ibër.<sup>103</sup> Secila palë rrezikon të nxisë palën tjetër për përleshje. Për shembull, serbët kanë ndërtuar mburoja përreth qytetit, të inspiruar pjesërisht nga një dokument i Ministrisë së Brendshme e

Serbisë (MUP) që pretendon se prezanton planet e detajuara të shqiptarëve për një sulm.<sup>104</sup>

Pjesa e parë e vitit 2007 duket të mos jetë shumë e rrezikshme, posaçërisht nëse komuniteti ndërkombëtar tregon në mënyrë të qartë se procesi për përcaktimin e statusit është duke shkuar përpara. Vetë kujtimi i kaosit të marsit 2004 shkakton përmbajtje të shumica e shqiptarë të cilët i përkujtojnë ato ngjarje si të turpshme dhe dëshirojnë që me çdo kusht të evitojnë çdo mundësi për përsëritjes e tyre.<sup>105</sup> Në vitin 2004 shënjestër e parë ishin serbët e Kosovës e pastaj UNMIK-u. IPVQ-ja do të mund të ishte e para në listë tani. Zemërimi i përgjithshëm në IPVQ-në dhe në Ekipin e Unitetit do të mund të shpërthente në qoftë se duket që këto institucione po dështojnë të sjellin pavarësinë e premtuar. Sondazhet tregojnë për rritjen e pakënaqësisë me efikasitetin e IPVQ-së si në nivelin qendror ashtu edhe në atë komunal.<sup>106</sup> Disa shqiptarë shprehin keqardhje për dhunën e marsit 2004, e cila ishte orientuar gabimisht kah serbët e pafajshëm.<sup>107</sup> Disa nga ekstremistët e ish UÇK-së flasin për “vrasjen” e politikanëve të tyre nëse ata dështojnë prapë.<sup>108</sup> Vetëvendosja nuk kishte shfrytëzuar këtë ndjenjë, por goditja që ajo bëri, më 28 nëntor shkoi mjaft përtej sulmeve të zakonshme të saj ndaj UNMIK-ut. Liderët e IPVQ-së u janë mënjanuar konfrontimeve, duke kërkuar

<sup>104</sup> Intervistë e Grupit të Krizave me një burim të policisë së UNMIK-ut, 7 dhjetor 2006.

<sup>105</sup> Intervista të Grupit të Krizave, nëntor-dhjetor 2006. Kjo është e ndryshme me interpretimin që dëgjohen shpesh nga disa qarqe ndërkombëtare se trazirat e marsit 2004 ishin të organizuar nga qendra dhe se ishin një komplot i shqiptarëve të Kosovës. Shih Raportin e Grupit të Krizave Nr.155, *Kolapsi në Kosovë*, 22 Prill 2004.

<sup>106</sup> Sondazhet e paraqitura në Raportin për Paralajmërim të Hershëm, projekt i financuar nga USAID dhe UNDP, tregojnë në rënie të theksuar të popullaritetit të qeverisë, prej 80% në fillim të vitit 2005 në 40% në fund të majit shtator 2006. Vlerësimi për Kuvendin e Kosovës, ka pësuar rënie drastike prej mbi 70% në fillim të vitit 2005 në 20% në fund të muajit shtator 2006. Hulumtimi i qeverisjes lokale i bërë nga projekti tjetër i UNDP-së, “Mozaiku i Kosovës 2006” i publikuar në tetor, tregon një rritje të pakënaqësisë së qytetarëve që nga viti 2003, të njejtë me atë të treguar për qeverinë. Shih <http://www.kosovo.undp.org>. sondazhet tregojë rënie të njëjta për UNMIK-un, në vitet pas trazirave të marsit 2004.

<sup>107</sup> Intervista të Grupit të Krizave, Prishtinë, perëndim dhe lindje të Kosovës, prill- nëntor 2006.

<sup>108</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, Viti, nëntor 2006. Njerëzit me maska të cilët u shfaqën në një fshat në perëndim të Kosovës më 4 dhjetor, ku kishin vendosur një pikë kontrolli, shkëmbyen zjarr me policinë e Kosovës. Pak më vonë, policia pranoi disa thirrje telefonike nga ta të cilët shprehën keqardhjen e tyre dhe si thuhet, shpjeguan se ata dëshirojnë të sulmojnë politikanët e Kosovës.

<sup>101</sup> Intervistë e Grupit të Krizave me një zyrtar të UNMIK-ut në Prishtinë, 11 dhjetor 2006. Në takimin e Këshillit të Sigurimit për Kosovën të datës 13 dhjetor, PSSP-ja, Rucker tha: “bisedimet e fundit kanë qenë inkurajuese. Po shpresojmë se kjo do të rezultojë përfundimisht me vendimin e komunitetit serb të Kosovës për ta njohur KEK-un dhe paguar rrymën”.

<sup>102</sup> Intervista të Grupit të Krizave, nëntor 2006.

<sup>103</sup> Shih Raportin e Grupit të Krizave, *Statuşi i Kosovës*, op. cit., f. 19-23 për disa të dhëna në çështjen e sigurisë në Mitrovicë në majin nëntor 2006. Që nga atëherë, kur siç ishte raportuar, ishte bërë zëvendësimi i shefit të stacionit verior të policisë serbe (MUP-it), në Mitrovicë, Dragoljub Delibasic (një bashkëpunor i Jakshiqit dhe Ivanovićit) gjërat kanë shkuar më ndryshe. Ai është kthyer prap në detyrë.

nga policia e Kosovës të largoheshin edhe pse ndërtesat e tyre po dëmtoheshin.<sup>109</sup>

Si do të përgjigjeshin politikanët e Kosovës nëse do të sfidoheshin seriozisht në rrugë? Në mbrëmjen e protestave të 28 nëntorit, lideri opozitar i PDK-së, Hashim Thaçi, insistoi që “pavarësia do të arrihet nga institucionet dhe jo nga rruga”.<sup>110</sup> Ai në mënyrë të vazhdueshme ka thënë se Kosova mund të fitojë shtetësinë vetëm në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar. Partia tjetër pasardhëse e UÇK-së, partnere e koalicionit qeverisës, AAK-ja e Ramush Haradinajt, duket të jet më e njëanshme, një tendencë të cilës mund t’i bashkohet, në muajt e ardhshëm, edhe anëtarët e pakënaqur të krahut të mundur të Dacit, në kuvendin e fundit zgjedhor të LDK-së.<sup>111</sup> Menjëherë pas shpalljes së vendimit për shtyrjen e procesit të statusit, nga ana e Ahtisaarit, AAK-ja deklaroi publikisht për mundësinë e shpalljes së pavarësisë, në Parlament.<sup>112</sup> Mungesa e përfaqësimit direkt e kësaj partie në Ekipin e Unitetit, pozita e dobësuar e saj në qeveri dhe largimi në të ardhmen i Haradinajt për në Hagë, për shkak të fillimit të gjyqimit për krimet e luftës, mund ta inkurajojnë një pozicionim më radikal në të ardhmen.<sup>113</sup>

Politikanët e Kosovës mund të mendojnë për shpalljen e njëanshme të pavarësisë, nëse arrijnë në përfundim se nuk kanë opSION tjetër për t’iu shmangur ndonjë rebelim në rrugë apo ndonjë sfidë të rrezikshme nga grupe ta armatosura jozyrtare. Ata pranojnë, sidoqoftë, se Kosova do të mund të gjendej ne geton nëse ndodh kjo, se do të mbeten pa përkrahjen ndërkombëtare dhe se do

t’i krijonte më shumë hapësirë Beogradit për të për të vazhduar me të tyren.<sup>114</sup> Ata do të ngurrojnë të marrin një hap të tillë përderisa nuk dëshpërohen-ose përderisa procesi i statusit të mos fundoset pa shpresë në Këshillin e Sigurimit, dhe t’u epet një shenjë aprovimi nga përkrahësit kyç, posaçërisht nga SHBA-të “Duhet të gjejmë momentin e duhur që dhemb më pak dhe nuk i zemëron miqtë tanë”, tha një anëtar i Parlamentit nga radhët e LDK-së.<sup>115</sup>

#### IV. KONKLUZION

Kosova, në shumë aspekte ka shumë për të bërë për të tejkaluar gjendjen e vitit 1999. Pjesërisht, kjo është edhe rezultat i mosangazhimit të komunitetit ndërkombëtar për një zhvillim ekonomik i cili do të kishte mundësuar një transformim të strukturave të shoqërisë dhe dinamikës së saj. Ideja fillestare se rezoluta 1244 mund të ngrinte zhvillimet politike, ndërsa do ta rimëkëmbte ekonominë dhe ndryshonte gjendjen e vështirë sociale ishte iluzion. Investimet private kanë stagnuar dhe për shkak të statusit të pazgjidhur, Kosova nuk mund të marr hua ndërkombëtare dhe vendimet e saj strategjike janë shtyre për pas zgjidhjes së statusit. Zhvillimi ka qenë negativ në vitin 2005 dhe në rastin më të mirë rritja do të jetë 2 për qind në vitin 2006.<sup>116</sup>

Edhe zgjidhja e duhur dhe e drejtë e statusit do të mund të shkaktonte probleme të tjera ekonomike, duke kufizuar kështu mundësitë e Kosovës për ndërtimin e paqes së brendshme. Është e mundshme, që në fazën e parë të pas statusit të ndodhë një krizë ekonomike. Marrëveshja mund t’ia rialokojë Kosovës një pjesë të borxheve ndërkombëtare të Serbisë. Për më tepër, Kosovës do t’i duhet të siguroj fonde shtesë për buxhetin e saj, për shpenzimet për krijimin e administratave të komunave të reja me shumicë serbe dhe financimin e tyre, të cilat nuk janë të planifikuara në buxhetin e qeverisë për vitin 2007. Prezenca civile ndërkombëtare do të zvogëlohet përnjëherë, duke zvogëluar deri në 3 për qind BPK-në e ekonomisë së deformuar, e zhvilluar si ekonomi e konsumit, e cila është e varur nga ndihmat humanitare, nga të ardhurat nga diaspora dhe nga të ardhurat nga punësimi në organizatat ndërkombëtare. Ekziston një mendim se Kosova ka përfituar më shumë se i ka takuar nga donacionet humanitare gjatë periudhës së administrimit të UNMIK-ut,. Gjithashtu, mendohet se

<sup>109</sup> Lajmet televizive shfaqën pamje të demonstruesve duke e sulmuar UNMIK-un për shkak se policia përdori gazin lotsjellës kur një mjet nxitës u hedh mbi ndërtesën e UNMIK-ut.

<sup>110</sup> Lajmet e RTK-së, të orës 7.30 të mbrëmjes, 27 nëntor 2006.

<sup>111</sup> Nëse komuniteti ndërkombëtar mendon për krijimin e një koalicioni të ri qeverisës, në mes të krahut të Sejdiut të LDK-së dhe PDK-së, duhet ta marrin parasysh se kjo mund të krijojë në anën tjetër një koalicion opozitar mjaft të ashpër ndaj këtij koalicioni. Gazeta ditore militante, *Epoka e Re*, e konsideruar formalisht e afërt me PDK-në, në të cilën, tani më veç po shfaqen pakënaqësitë që vinë nga anë të ndryshme, duke ofruar kështu një platformë për Vetëvendosjen e Albin Kurtit, veteranët e Luftës, dhe me gjasë krahun e Dacit nga LDK.

<sup>112</sup> Deklaratë për media e AAK-së, 10 nëntor 2006.

<sup>113</sup> Thuhet se vetura të ministrisë së punës dhe mirëqenies sociale, e kontrolluar nga AAK, të kenë transportuar shishët me ngjyrë të Vetëvendosjes të cilat u hodhën në protestën e 28 nëntorit, mbi ndërtesën e qeverisë, parlamentit dhe UNMIK-ut. Shih “Veturat e Ministrisë në shërbim të ‘Vetëvendosjes’”, *Koha Ditore*, 1 dhjetor 2006. Ndoshta me nguti, Thaçi akuzoi forcat “para-politike” që qëndrojnë mbrapa koalicionit qeverisës LDK-AAK (ky është kodi i tij për Haradinajn) për orkestrimin e paraqitjes së maskave në Kosovën perëndimore, më 4 dhjetor. Shih artikullin e Nebih Maxhuni, “Maskat parapolitike”, *Express*, 9 dhjetor 2006.

<sup>114</sup> Një diplomat i lartë perëndimor vlersoi shumë ashpër pozitën e Kosovës në një rast të tillë, duke thënë se ata do të “të ia hedhin vetes”, intervistë e Grupit të Krizave, 16 nëntor 2006.

<sup>115</sup> Intervistë e Grupit të Krizave, 9 tetor 2006.

<sup>116</sup> Të dhëna të Bankës Botërore, të prezantuara nga konsultantja Barbara Balaj, Washington DC, 14 nëntor 2006.

donatorët do të kenë më pak vullnet për financimin e fushave siç është arsimi, edhe pse rinia kosovare po ballafaqohet me një mungesë të zhvillimit strategjik të edukimit. Komuniteti ndërkombëtar është i gatshëm të bëjë shpenzime të mëdha ushtarake për të siguruar paqen por siç duket do të brengoset shumë pak për zhvillimin e Kosovës dhe ndërtimin e paqes.

E tëra kjo e bën të domosdoshëm shfrytëzimin e vitit 2007, nga elita kosovare, institucionet dhe shoqëria për një vendosmëri të madhe: larg nga kërcënimet për kriza dhe drejt një vetëqeverisje të qëndrueshme. Nën administrimin e UNMIK-ut, liderët kosovar të cilët kërkonin vazhdimisht pavarësi për vendin e tyre, neglizhonin fushat e qeverisjes për të cilat kishin kompetencat dhe përqendronin energjitë e tyre për marrjen e atyre kompetencave tjera që nuk i kishin. Kërcënimi i nënkuptuar me kaos, nëse Kosova nuk e fiton atë për të cilën është duke pritur gjatë, frikëson shumë investitorët, për investimet e të cilëve Kosova ka shumë nevojë. Nëse do të ndodhnin trazira, edhe pas tejkalimit të tyre, ato përkundrazi do të ndikonin në ngushtimin e mundësive ai do të ndikojë në ngushtimin dhe jo në relaksim të mundësive për garancione të tilla edhe ashtu të pakta. Mungesa, me gjasë e disa atributëve shtetërore siç është ulësja në OKB dhe ndoshta për ballafaqim që duhet bërë me Serbinë nuk duhet të bëhen obsesione konsumuese në shtetit e ri që po lindë, liderët politik të të cilit po vazhdojnë të grabisin në kuletën e popullit. Nëse Kosova do të fitojë pavarësinë në vitin 2007 – siç duhet – në të njëjtën kohë duhet të maturohet dhe konsolidohet.

**Prishtinë/Bruksel, 20 Dhjetor 2006**



## APENDIKS A

### HARTA E KOSOVËS

